



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.44**

**25 prill**

**2011**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 407 datë 31.3.2011	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Fondi Shqiptar për Zhvillim, si agjenci e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Fondi i investimeve sociale IV””.....	1853
Vendim i GJK nr.11, datë 12.4.2011	Me objekt: 1. Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë nr.505, datë 10.4.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. 2. Detyrimin e drejtorisë rajonale të arsimit të qarkut Elbasan për t’i shpërblyer kërkuesit dëmin pasuror e jopasuror në sasinë e vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese nëpërmjet ekspertëve.....	1897
Vendim i GJK nr.12, datë 15.4.2011	Me objekt: 1. Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë nr.120, datë 13.11.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë. 2. Dënimi me 100 000 (njëqind mijë) lekë gjobë të subjektit të interesuar, Rezarta Jorgji, në rast moszbatimi ose pengimi të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.....	1900

**LIGJ**  
**Nr.10 407, datë 31.3.2011**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË DHE PROGRAMIT NDËRMJET  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE  
FONDI SHQIPTAR PËR ZHVILLIM, SI AGJENCI E ZBATIMIT TË PROJEKTIT, DHE KfW  
FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “FONDI I INVESTIMEVE  
SOCIALE IV””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Fondi Shqiptar për Zhvillim, si agjenci e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Fondi i investimeve sociale IV””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6971, datë 12.4.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**MARRËVESHJE HUAJE DHE PROGRAMI**

**NDËRMJET KfW, FRANKFURT AM MAIN (KfW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,  
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, TIRANË (HUAMARRËSI) DHE FONDIT  
SHQIPTAR PËR ZHVILLIM (FSHZH), TIRANË (AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT) PËR  
20 MILIONË EURO (HUAJA) DHE FONDIT TË INVESTIMIT SOCIAL IV**

**Preambulë**

Baza për këtë marrëveshje huaje dhe programi është marrëveshja që duhet të lidhet ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi bashkëpunimin financiar (FC) (marrëveshja qeveritare).

Me kushtin që Republika Federale e Gjermanisë të japë subvencionet për normat e interesit dhe me kushtin që Republika Federale e Gjermanisë të japë një garanci për huan, KfW-ja do të japë huan në pajtim me termat dhe kushtet e kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi. Termat dhe kushtet e huas përpunohen me kërkesat e OECD-së të zbatueshme në datën e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi për njohjen si asistencë zyrtare për zhvillimin (ODA).

**1. Huaja**

1.1 Shuma. KfW-ja do t'i japë Huamarrësit një hua që nuk kalon një total prej 20 milionë euro (huaja).

1.2 Kanalizimi dhe qëllimi i huas. Huamarrësi e kanalizon huan plotësisht tek agjencia e zbatimit të programit në pajtim me kushtet e parashikuara në nenin 2. Agjencia e zbatimit të projektit përdor huan vetëm për të financuar rehabilitimin, rindërtimin ose ndërtimin e sistemeve të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve, si dhe rehabilitimin ose rindërtimin e rrjetit rrugor rural (Programi). Agjencia e zbatimit të programit dhe KfW-ja do të përcaktojë hollësitë e programit, si dhe mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen nga huaja në një marrëveshje të veçantë që duhet të miratohet nga Huamarrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave.

1.3 Tatimet, detyrimet, detyrimet doganore. Tatimet dhe detyrimet e tjera publike që duhet të shlyhen nga huamarrësi ose agjencia e zbatimit të programit, si dhe detyrimet doganore nuk mund të financohen nga huaja.

2. Kanalizimi i huas tek agjencia e zbatimit të programit

2.1 Marrëveshja e veçantë e huas. Huamarrësi e kanalizon huan tek agjencia e zbatimit të programit si një grand të pakthyeshem sipas një marrëveshjeje të veçantë financiare.

2.2 Përkthimi i certifikuar. Para disbursimit të parë nga huaja, Huamarrësi i dërgon KfW-së një përkthim të certifikuar në anglisht ose gjermanisht të marrëveshjes së financimit të specifikuar në nenin 2.1.

2.3 Mosekzistenca e detyrimit për agjencinë e zbatimit të projektit. Kanalizimi i huas nuk përbën ndonjë detyrim për agjencinë e zbatimit të projektit kundrejt KfW-së për detyrime pagese sipas kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi.

3. Disbursimi

3.1 Kërkesa për disbursim. Menjëherë sapo të përmbushen kushtet paraprake për disbursimin në pajtim me nenin 3.3, KfW-ja disburson huan në pajtim me përparimin e programit me kërkesën e agjencisë së zbatimit të programit. Disbursimi realizohet në pajtim me grafikun e disbursimit që gjendet në aneksin 1 të kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi. KfW-ja bën disbursime deri në shumat maksimale të përcaktuara për çdo gjashtëmuor. Në masën që agjencia e zbatimit të programit kërkon disbursime për shuma më të vogla brenda një gjashtëmuor, shumat e padisbursuara mund të kërkohen në çdo periudhë gjashtëmuore pasuese.

3.2 Afati i fundit për kërkimin e disbursimeve. KfW-ja mund të refuzojë disbursimet pas datës 30/12/2013.

3.3 Kushtet paraprake të disbursimit. KfW-ja është e detyruar të bëjë disbursime të çdo shume sipas kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi vetëm me përmbushjen e kushteve të mëposhtme paraprake në një formë dhe përmbajtje të pranueshme për KfW-në:

a) Huamarrësi ka demonstruar duke paraqitur një mendim ligjor thelbësisht sipas formës së parashikuar në aneksin 2 dhe duke paraqitur kopje të vërtetuara (secila me një përkthim në anglisht) të të gjithë dokumenteve të cilave u referohet ky mendim ligjor që:

aa) Huamarrësi ka përmbushur të gjitha kërkesat sipas të drejtës së tij kushtetuese dhe dispozitave të tjera ligjore, dhe

bb) KfW-ja është e përjashtuar nga të gjitha tatimet mbi të ardhurat nga interesi, detyrimet, tarifatat dhe kostot e ngjashme në Republikën e Shqipërisë për dhënien e huas;

b) nënshkrimet ekzemplare të përmendura në nenin 13.1 (Përfaqësimi i Huamarrësit dhe agjencisë së zbatimit të programit) janë paraqitur;

c) garancia nga Republika Federale e Gjermanisë e përmendur në nenin 8 është në fuqi pa asnjë kufizim;

d) Huamarrësi ka paguar tarifën e menaxhimit të përmendur në nenin 4.2;

e) Nuk ka ndodhur dhe nuk mendohet të ndodhë ndonjë shkak për zgjidhje; dhe

f) Nuk kanë ndodhur rrethana të jashtëzakonshme që përjashtojnë ose rrezikojnë zbatimin, operimin ose qëllimin e programit, ose përmbushjen e detyrimeve të pagesës të marra përsipër nga Huamarrësi sipas kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi, dhe

g) KfW ka marrë përkthim të certifikuar në anglisht ose gjermanisht të marrëveshjes së financimit të specifikuar në nenin 2.1 dhe 2.2.

Para disbursimit nga huaja, KfW-ja ka të drejtën të kërkojë ato dokumente dhe prova të tjera që ajo i konsideron të nevojshme.

3.4 Marrëveshja e veçantë. Në një marrëveshje të veçantë që duhet të miratohet nga Huamarrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave, agjencia e zbatimit të programit dhe KfW-ja do të specifikojnë procedurën e disbursimit dhe veçanërisht provat që duhet të jepen nga agjencia e zbatimit të programit që provojnë se shumat e kërkuara të huas përdoren për qëllimin e parashikuar në këtë marrëveshje huaje dhe programi.

3.5 Heqja dorë nga disbursimi. Në pajtim me përmbushjen e detyrimeve të tij sipas nenit 11, Huamarrësi mund të heqë dorë nga disbursimi i shumave të padisbursuara të huas me pëlqimin e KfW-së, në këmbim të pagesës së kompensimit të mospranimit në pajtim me nenin 3.6.

3.6 Kompensimi i mospranimit. Nëse Huamarrësi heq dorë nga disbursimi i një shume huaje, ose nëse një shumë huaje nuk disbursohet fare ose nuk disbursohet brenda afatit të përcaktuar në nenin

3.2 për shkaqe të tjera për të cilat KfW-ja nuk mund të bëhet përgjegjëse, huamarrësi, jo më vonë se 10 ditë pune nga kërkesa e parë, i paguan KfW-së me kërkesë atë shumë që është normalisht e arsyeshme për të kompensuar KfW-në për çdo humbje, shpenzim ose kosto të pësuar nga KfW-ja si rezultat i mospranimit të shumës së huas në fjalë. KfW-ja llogarit shumën e kompensimit të mospranimit dhe ia komunikon atë Huamarrësit.

#### 4. Tarifat

4.1 Tarifa e përkushtimit. Huamarrësi paguan një tarifë të pakthyeshme përkushtimi prej 0.25% p.a. për shumat e padisbursuara të huas. Tarifa e përkushtimit llogaritet për periudhën që fillon me kalimin e periudhës tremujore pas nënshkrimit të marrëveshjes së huas dhe programit dhe që vazhdon deri në atë datë kur huaja është disbursuar plotësisht, ose anuluar plotësisht, sipas rastit.

Tarifa e përkushtimit është e kërkueshme për pagesë dy herë në vit dhe në shuma të prapambetura më 30 qershor dhe 30 dhjetor të çdo viti (secila “datë pagese”). Për herë të parë është e kërkueshme për t’u paguar më 30 qershor 2011 por jo më parë se data e pagesës pas së cilës kjo marrëveshje huaje dhe programi hyn në fuqi në pajtim me nenin 14.11.

4.2 Tarifa e menaxhimit. Huamarrësi i paguan KfW-së një tarifë të përgjithshme, të njëhershme dhe të pakthyeshme menaxhimi të barabartë me 1 % të shumës kryesore të huas së caktuar në nenin 1.1.

Tarifa e menaxhimit bëhet e kërkueshme në kohën më të hershme: i) para disbursimit të parë sipas huas; ose ii) pas kalimit të një periudhe tremujore pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje me KfW ose pas përfundimit të një periudhe një mujore pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje (cilado prej këtyre datave të kërkueshme të deklaruara sipas (ii) që ndodh më vonë). Në momentin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, tarifa e menaxhimit do të rritet plotësisht, pavarësisht nga fakti nëse huaja do të disbursohet e plotë apo nëse nuk do të disbursohet fare.

#### 5. Interesi

Huamarrësi i paguan KfW-së interes me një normë që përcaktohet si më poshtë:

5.1 Interesi (norma fikse e interesit e caktuar mbi dhënien e huas). Huamarrësi paguan normë interesi mbi huan me një normë prej 2.0% p.a. (normë fikse interesi) deri në marrjen e kështit të fundit të shlyerjes sipas grafikut të shlyerjes sipas përcaktimit në nenin 6.1.

5.2 Llogaritja e interesit dhe datat e pagesës së interesit. Interesi për një shumë të disbursuar të huas do të ngarkohet nga data (duke e përjashtuar), në të cilën shuma përkatëse e huas paguhet nga llogaria e huas që mbahet tek KfW-ja për Huamarrësin deri në datën (duke e përfshirë), në të cilën shlyerjet përkatëse kreditohen në llogarinë e KfW-së të përcaktuar në nenin 7.3. Interesi do të paguhet me shumat e prapambetura në datat e pagesave (sipas përcaktimit në nenin 4.1).

#### 6. Shlyerja dhe parapagimi

6.1 Grafiku i shlyerjes. Huamarrësi e shlyen huan si më poshtë:

Kësti	Datë		Shuma	
1	qershor 30	2014	833,000	euro
2	dhjetor 30	2014	833,000	euro
3	qershor 30	2015	833,000	euro
4	dhjetor 30	2015	833,000	euro
5	qershor 30	2016	833,000	euro
6	dhjetor 30	2016	833,000	euro
7	qershor 30	2017	833,000	euro
8	dhjetor 30	2017	833,000	euro
9	qershor 30	2018	833,000	euro
10	dhjetor 30	2018	833,000	euro
11	qershor 30	2019	833,000	euro
12	dhjetor 30	2019	833,000	euro
13	qershor 30	2020	833,000	euro
14	dhjetor 30	2020	833,000	euro
15	qershor 30	2021	833,000	euro

16	dhjetor 30	2021	833,000	euro
17	qershor 30	2022	834,000	euro
18	dhjetor 30	2022	834,000	euro
19	qershor 30	2023	834,000	euro
20	dhjetor 30	2023	834,000	euro
21	qershor 30	2024	834,000	euro
22	dhjetor 30	2024	834,000	euro
23	qershor 30	2025	834,000	euro
24	dhjetor 30	2025	834,000	euro

6.2 Shumat e padisbursuara të huas. Shumat e padisbursuara të huas do të kompensohen kundrejt këstit përkatës të fundit të shlyerjes në pajtim me grafikun e shlyerjes, përveç kur KfW-ja, sipas diskrecionit të saj, vendos një alternativë tjetër kompensimi në raste të veçanta pas para njoftimit paraprak të huamarrësit.

6.3 Disbursimet pas fillimit të shlyerjes. Nëse shumat e huas disbursohen pasi të ketë filluar shlyerja, grafiku i shlyerjes sipas renditjes në nenin 6.1 mbetet e paprekur për sa kohë që kësti përkatës i shlyerjes i kërkueshëm në pajtim me grafikun e shlyerjes është më i vogël se shumat e huas tashmë të disbursuara. Nëse kësti i shlyerjes i kërkueshëm për pagesa e kalon shumën e pakthyer të huas, KfW-ja zbret shumën e barabartë me diferencën nga kësti i kërkueshëm i shlyerjes, e pjesëton atë me mbetësin e kësteve të shlyerjes të pakthyera dhe ia shton këtë shumë secilit këst të pakthyer të shlyerjes. KfW-ja rezervon të drejtën të shtyjë marrjen në shqyrtim të disbursimeve që bëhen brenda 45 ditëve para datës përkatëse të pagesës për përcaktimin e shumës së pakthyer të huas deri në datën e dytë të pagesës pas disbursimit.

6.4 Parapagimi. Sa më poshtë zbatohet për shlyerjet e parakohshme:

a) E drejta për të bërë parapagesa. Huamarrësi, në pajtim me nënparagrafët “b” deri “e” më poshtë, mund të bëjë një pagesë të parakohshme në lidhje me një shumë huaje, me kusht që kjo pagesë e parakohshme të jetë të paktën në shumën e një kësti shlyerjeje në pajtim me nenin 6.1.

b) Njoftimi. Një parapagim i një shume huaje në pajtim me nenin 6.4 a i nënshtrohet një njoftimi parapagimi nga Huamarrësi drejtuar KfW-së jo më vonë se dita bankare e pesëmbëdhjetë (sipas përcaktimit në nenin 14.1) në Frankfurt mbi Main para datës së përcaktuar të parapagimit. Ky njoftim është i parevokueshëm; ai duhet të përcaktojë datën në të cilën do të bëhet parapagimi dhe shuma e tij që detyron Huamarrësin t’i paguajë KfW-së shumën e përcaktuar në datën e caktuar.

c) Kompensimi i parapagimit. Nëse Huamarrësi parapaguan një shumë huaje me një normë fikse interesi, huamarrësi, brenda 10 ditëve pune, i paguan KfW-së me kërkesë atë shumë që është normalisht e nevojshme për të kompensuar çdo humbje, shpenzim ose kosto të shkaktuar KfW-së si rezultat i parapagimit. KfW-ja përcakton shumën e kompensimit të parapagimit dhe ia komunikon atë Huamarrësit.

d) Shumat e kërkueshme. Huamarrësi paguan gjithashtu shumat e mëposhtme, së bashku me parapagesën në pajtim me nenin 6.4 “a” deri “c”:

aa) çdo kompensim parapagese të kërkueshëm si rezultat i parapagimit në pajtim me nenin 6.4 c); dhe

bb) të gjithë interesin e mbledhur mbi shumën e parapaguar të huas deri në datën e parapagimit.

e) Kompensimi. Neni 6.2 (Shumat e padisbursuara të huas) zbatohen *mutatis mutandis* për kompensimin e parapagimeve.

6.5 Grafiku i rishikuar i shlyerjeve. Në rastin kur zbatohet neni 6.2 (shumat e padisbursuara të huas), neni 6.3 (disbursimet fillimit të shlyerjes) ose neni 6.4 (parapagimi), KfW-ja i dërgon Huamarrësit një grafik të rishikuar shlyerjeje që bëhet pjesë integrale e kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi dhe zëvendëson grafikun e shlyerjes të vlefshëm deri në atë kohë.

7. Llogaritjet dhe pagesat në përgjithësi

7.1 Llogaritja. Interesi, tarifa e përkushtimit, interesi i munguar në pajtim me nenin 7.5, kompensimi i plotë për shumat e prapambetura në pajtim me nenin 7.6, kompensimi i papranueshëm dhe kompensimi i parapagimit do të llogariten mbi bazën e një viti me 360 ditë me muaj me 30 ditë.

7.2 Data e kërkueshme. Nëse një pagesë që bëhet në lidhje me këtë marrëveshje huaje dhe programi bëhet e kërkueshme në një datë që nuk është ditë bankare (sipas përcaktimit në nenin 14.1)

Huamarrësi duhet ta bëjë këtë pagesë në ditën bankare pasuese. Nëse dita pasuese bankare bie në muajin kalendarik pasues, pagesa përkatëse bëhet në ditën e fundit bankare të muajit kalendarik përkatës.

7.3 Numri i llogarisë, koha e kreditimit. Huamarrësi lirohet nga detyrimet e tij të pagesës në lidhje me këtë marrëveshje huaje dhe programi nëse dhe menjëherë sapo shumat përkatëse t'i jenë kredituar kfw-së në disponim të saj të lirë pa asnjë zbritje në euro dhe jo më vonë se ora 10:00 paradite në Frankfurt mbi Main në llogarinë e KfW-së /IBAN DE 09 5002 0400 3102 5608 01 që mbahet nga KfW-ja, Frankfurt mbi Main, me referencë shtesë në datën e kërkueshme (Ref. VVVVMMDD")

7.4 Kundërpretendimet e Huamarrësit. Huamarrësi nuk ka të drejtë të ngrejë asnjë pretendim mbajtjeje ose kompensimi apo të drejta të ngjashme ndaj detyrimeve për pagesa sipas kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi, përveç kur këto të drejta njihen me vendim përfundimtar dhe nuk kundërshtohen nga KfW-ja.

7.5 Interesi i munguar. Nëse një këst shlyerjeje ose një parapagesë në pajtim me nenin 6.4 (parapagimi) nuk janë në dispozicion të KfW-së kur bëhen të kërkueshme, KfW-ja, pa paralajmërim, mund të ngarkojë interes me një normë prej 300 pikë bazë p.a. mbi normën bazë për periudhën që fillon në datën e kërkueshme dhe që mbaron në datën në të cilën këto pagesa kreditohen në llogarinë e KfW-së të specifikuar në nenin 7.3. Kjo normë duhet të paktën të jetë e barabartë me normën e interesit të huas. "Norma bazë" është norma e interesit e njoftuar nga Banka Qendrore Gjermane (Deutsche Bundesbank) si norma bazë që mbizotëron në datën përkatëse të kërkueshme. Ky interes i munguar bëhet menjëherë i kërkueshëm pas kërkesës së parë të KfW-së dhe duhet të paguhet brenda 10 ditëve pune.

7.6 Kompensimi me shumë të plotë. Për shumat e prapambetura (me përjashtim të atyre kësteve të shlyerjeve dhe parapagesave të përmendura në nenin 7.5 (interesi i munguar), KfW-ja, pa paralajmërim, mund të kërkojë kompensim me shumë të plotë me një normë prej 300 pikë bazë p.a. mbi normën bazë të zbatueshme në datën përkatëse të kërkueshme për periudhën që fillon në datën e kërkueshme dhe që mbaron në datën e pagesës së këtyre shumave të prapambetura. Kompensimi me shumë të plotë bëhet menjëherë i kërkueshëm pas kërkesës së parë të KfW-së dhe duhet të paguhet brenda 10 ditëve pune. Huamarrësi është i lirë të provojë që faktikisht nuk është shkaktuar asnjë dëm ose që dëmet nuk janë shkaktuar në shumën e përcaktuar.

7.7 Kompensimi. KfW-ja ka të drejtën të kompensojë pagesat e marra kundrejt pagesave të kërkueshme sipas kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi ose sipas marrëveshjeve të tjera të huas të lidhura ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit. Në këtë rast, Huamarrësi do të informohet pa vonesë nga KfW-ja.

7.8 Llogaritë e bëra nga KfW-ja. Në mungesë të gabimeve të dukshme në përcaktimet e KfW-së dhe llogaritjen e shumave sipas kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi dhe në lidhje me këtë marrëveshje huaje dhe programi përbëjnë provë *prima facie*.

#### 8. Garancia nga Republika Federale Gjermane

KfW-ja do të marrë garanci nga Republika Federale Gjermane për pretendimet e pagesave sipas kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi para disbursimit të parë.

#### 9. Pengu negative dhe *pari passu*

9.1 Ndalimi i pengut ose hipotekës. Huamarrësi dhe agjencia e zbatimit të programit marrin masat që sendet e programit të mos rëndohen me peng ose hipotekë dhe as të tjetërsohen para shlyerjes së plotë të huas dhe që Huamarrësi nuk lidh asnjë marrëveshje ose masë tjetër nëse efekti i saj është krijimi i një garancie ose një të drejte që jep një prioritet pagese në lidhje me një detyrim të një personi pa pëlqimin paraprak të KfW-së.

9.2 *Pari passu*. Në masën që lejohet nga ligji, Huamarrësi merr përsipër të përmbushë detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje huaje dhe projekti *pari passu* me të gjitha detyrimet e saj ekzistuese ose të ardhme për pagesë, të pasiguruara dhe të pavarura.

#### 10. Kostot dhe detyrimet publike

10.1 Ndalimi i zbritjeve ose mbajtjeve. Huamarrësi bën të gjitha pagesat sipas kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi pa asnjë zbritje për tatimet, detyrimet e tjera publike ose kosto të tjera. Në rastin që Huamarrësi është i detyruar me ligj ose shkaqe të tjera të bëjë zbritje ose ndalesa të tilla mbi pagesat, Huamarrësi paguan çdo shumë të tillë të nevojshme shtesë për KfW-në, në mënyrë që shuma neto që mbetet pas çdo ndalesë ose zbritjeje të përputhet me shumën që do të ishte e pagueshme sipas kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi, nëse nuk do të ishin bërë këto zbritje ose ndalesa.

10.2 Kostoja. Huamarrësi mbulon të gjitha shpenzimet dhe kostot që shkaktohen në lidhje me disbursimin e huas, veçanërisht koston e dërgimit dhe transferimit (duke përfshirë tarifat e konvertimit),

si dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet që shkaktohen në lidhje me mbajtjen ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi.

10.3 Tatimet dhe detyrimet e tjera. Huamarrësi mbulon të gjitha tatimet dhe detyrimet e tjera publike që shkaktohen jashtë Republikës Federale Gjermane në lidhje me lidhjen dhe nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi.

10.4 Kostot e shtuara. Nëse për shkak të:

a) përmbushjes së kërkesave të lëshuara nga banka qendrore ose një autoritet tjetër fiskal, monetar ose tjetër pas datës së kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi,

ose

b) një ndryshimi në ligj ose interpretimit dhe administrimit të tij,

ose

c) hyrjes në fuqi, zgjidhjes ose ndryshimit të një marrëveshjeje ose traktati të zbatueshëm bilateral ose multilateral, veçanërisht mbi tatimin e dyfishtë,

KfW-ja pëson kosto ose humbje shtesë ose nuk është në gjendje të marrë marzhin e rënë dakord mbi koston e saj të rifinancimit si rezultat i lidhjes dhe financimit të kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi (kosto të rritura), KfW-ja njofton për këtë Huamarrësin. Çdo kërkesë e tillë nga KfW-ja shoqërohet me një njoftim nga KfW-ja që deklaron shkakun për këtë kërkesë dhe përcakton me hollësi të arsyeshme llogaritjen e shumës përkatëse. Huamarrësi zhdëmton menjëherë KfW-në me kërkesë për të gjitha kostot e shtuara. Neni 7 zbatohet *mutatis mutandis*.

11. Detyrime të veçanta

11.1 Zbatimi i programit dhe informacioni i veçantë. Agjencia e zbatimit të programit:

a) përgatit, zbaton, operon dhe mban programin në pajtim me praktikatat e shëndosha financiare dhe teknike dhe thelbësisht në pajtim me konceptin e programit të rënë dakord ndërmjet agjencisë së zbatimit të programit dhe KfW-së;

b) u ngarkon përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të programit inxhinierëve konsulentë ose konsulentëve të kualifikuar ose të pavarur dhe zbatimin e programit për firmat e kualifikuara;

c) jep kontratat për mallrat dhe shërbimet që financohen nga huaja me ofertim konkurrues ndërkombëtar paraprak;

dhe do të japë kontratën që duhet të financohet nga huaja për zbatimin dhe forcimin institucional për skemat rurale të ujësjellësit direkt për konsulentin që është punësuar në projektin prezent të furnizimit me ujë të zonave rurale, me kusht që të paraqitet një ofertë financiare dhe teknikisht e pranueshme;

d) mban libra dhe regjistra ose kujdeset për mbajtjen e librave dhe regjistrave që tregojnë qartësisht koston e të gjitha mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për programin dhe identifikon qartësisht mallrat dhe shërbimet e financuara nga huaja;

e) merr masa që përfaqësuesit e KfW-së të kenë mundësi në çdo kohë të inspektojnë librat dhe regjistrat dhe çdo dokumentacion tjetër në lidhje me zbatimin dhe operimin e programit, dhe për të vizituar programin dhe të gjitha instalimet në lidhje me të;

f) i jep KfW-së dhe merr masa që çdo informacion dhe regjistër i tillë mbi programin dhe përparimin e tij të mëtejshëm t'i jepet KfW-së sipas kërkesës së KfW-së;

g) menjëherë dhe me iniciativë të vet, i jep KfW-së çdo pyetje të marrë nga agjencia e zbatimit të programit nga OECD-ja ose anëtarët e tij sipas së ashtuquajturës "Marrëveshje për transparencën e kredive ODA të bashkuara pas dhënies së kontratave për furnizimet dhe shërbimet që do të financohen nga huaja dhe bashkërendon përgjigjet e këtyre pyetjeve me KfW-në, dhe

h) njofton KfW-në për sa më poshtë:

i) të gjitha çështjet në lidhje me pronësinë e tokës dhe e drejta e përdorimit duhet të zgjidhen nga agjencia e zbatimit të programit me njësinë qeveritare përkatëse vendore para fillimit të punimeve të ndërtimit. Fondet e Bashkëpunimit Financiar Gjerman nuk mbulojnë kostot e lidhura me pronësinë e tokës.

ii) Në rast se rrugët komunale financohen, duhet të nënshkruhet një marrëveshje investimi dhe një marrëveshje operimi dhe mirëmbajtjeje me komunën përkatëse para fillimit të ndërtimit.

iii) Mekanizmi sanksionues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit (përjashtimi i komunave për dy vjet nga financimi i mëtejshëm i programit) aplikohet për komunat të cilat nuk përmbushin marrëveshjen e operimit dhe mirëmbajtjes (OMA).

iv) Para nënshkrimit të plankontratave të hollësishme, njësitë e qeverisë vendore të përzgjedhura për programin ("Njësitë e qeverisë vendore", secila e referuar si një "njësi e qeverisë vendore")

provojnë të drejtat e tyre të pakufizuara të burimit uxor ose të drejtat e pakufizuara të shfrytëzimit të burimit uxor.

11.2 Marrëveshje e veçantë. Agjencia e zbatimit të programit dhe KfW-ja përcaktojnë hollësitë e nenit 11.1 me marrëveshje të veçantë që duhet të miratohet nga Huamarrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave.

11.3 Huamarrësi dhe agjencia e zbatimit të programit:

a) sigurojnë financimin e plotë të programit dhe sipas kërkesës, i japin KfW-së të dhëna që provojnë se kostot e paguara nga kjo hua mbulohen; dhe

b) me iniciativën e tyre, do të informojnë menjëherë KfW-në për: i) rastin ose rastin e mundshëm të mosplotësimit të detyrimeve; dhe ii) për çdo rrethanë që përjashton ose rrezikon zbatimin, funksionimin ose qëllimin e programit.

1.4 Huamarrësi:

a) ndihmon agjencinë e zbatimit të programit, në pajtim me praktikën e shëndosha inxhinierike dhe financiare, për zbatimin e programit dhe përmbushjen e detyrimeve të agjencisë së zbatimit të programit sipas marrëveshjes së huas dhe programit dhe në veçanti, i jep agjencisë së zbatimit të programit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e programit; dhe

b) pajtohet me sa më poshtë:

i) Miratimi i një marrëveshjeje të BERZH-it. Huamarrësi garanton që Autoriteti Shqiptar i Rrugëve të marrë në dorëzim mirëmbajtjen e të gjitha rrugëve rajonale deri në fund të vitit 2013. Rrjedhimisht, të gjitha rrugët rajonale të financuara nga fondet e KfW-së do të mirëmbahen nga Autoriteti Shqiptar i Rrugëve.

ii) Miratimi i një statusi marrëveshjeje të BERZH-it të marsit 2010. Huamarrësi do të rrisë financimin për Autoritetin Shqiptar të Rrugëve në lidhje me mirëmbajtjen e rrugëve gjatë secilit prej viteve fiskale që fillon më 1 janar 2011, 1 janar 2012 dhe 1 janar 2013 deri të paktën 10 % në vit, siç është rënë dakord ndërmjet BERZH-it dhe Republikës së Shqipërisë.

iii) Nëse një rrugë rajonale e financiar nga KfW-ja dhe e marrë përsipër të mirëmbahet nga Autoriteti Shqiptar i Rrugëve është degraduar (nuk garantohet më mirëmbajtja nga Autoriteti Shqiptar i Rrugëve), KfW-ja rezervon të drejtën për të tërhequr financimin për këtë rrugë përkatëse.

iv) Huamarrësi jep grante për mirëmbajtjen periodike të rrugëve të përmirësuara komunale nëse rezultojnë se njësitë e qeverisjes lokale nuk kanë mjete të mjaftueshme buxhetore.

11.5 Respektimi. Huamarrësi dhe agjencia e zbatimit të programit sigurojnë që personat të cilëve u besojnë përgatitjen dhe zbatimin e programit, dhënien e kontratës për furnizimet dhe shërbimet që do të financohen, dhe kërkimin e shumave të huas nuk kërkojnë, pranojnë, bëjnë, japin, premtojnë apo pranojnë premtimin e pagesave të paligjshme ose avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

11.6 Transporti i mallrave. Dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen qeveritare do të zbatohen për transportin e mallrave që financohen nga huaja.

12. Zgjidhja

12.1 Rast i mosplotësimit të detyrimeve. KfW-ja mund të ushtrojë të drejtat e parashikuara në nenin 12.2 (pasojat ligjore të një rasti të mosplotësimit të detyrimeve) nëse një rast ndodh dhe përbën një shkak të rëndësishëm (Wichtiger Grund). Veçanërisht, ngjarjet e mëposhtme përbëjnë një shkak të rëndësishëm:

a) Huamarrësi nuk përmbush detyrimet ndaj KfW-së për të bërë pagesat kur bëhen të kërkueshme;

b) detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi ose sipas marrëveshjes së financimit të datës \_\_\_\_\_ ose sipas marrëveshjeve të veçanta .....që duhet të miratohen nga Huamarrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave, në lidhje me ndonjë prej këtyre marrëveshjeve, janë shkëlur nga Huamarrësi dhe/ose agjencia e zbatimit të programit;

c) kjo marrëveshje huaje dhe programi ose çdo pjesë e saj pushon së pasuri efekt detyruet mbi Huamarrësin, agjencinë e zbatimit të programit ose pushon së qeni e ekzekutueshme ndaj Huamarrësit, agjencisë së zbatimit të programit ose garantuesit;

d) një deklaratë, konfirmim, informacion ose përfaqësim ose garanci e konsideruar nga KfW-ja thelbësore për dhënien dhe mbajtjen e huas rezultojnë të jetë fals, e gabuar ose e paplotë;

e) ndodhin rrethana të tjera të jashtëzakonshme që vonojnë ose përjashtojnë përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi; ose



f) Huamarrësi dhe/ose agjencia e zbatimit të programit nuk është në gjendje të provojë që shumat e huas janë përdorur për qëllimin e parashikuar;

g) një nga ngjarjet e mëposhtme ka ndodhur në lidhje me Huamarrësin:

aa) Huamarrësi nuk është në gjendje të paguajë borxhet kur bëhen të kërkueshme;

bb) fillimi i bisedimeve me një ose më shumë kreditorë të Huamarrësit (me përjashtim të KfW-së) mbi heqjen dorë nga borxhet e prapambetura ose për një moratorium ose shlyerje.

12.2 Pasojat ligjore të rastit të mosplotësimit të detyrimeve. Nëse një prej ngjarjeve të përmendura në nenin 12.1 ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe prej pesë ditësh (në rastin e nenit 12.1 a) ose, në të gjitha rastet e tjera të specifikuara në nenin 12.1, nuk është zgjidhur brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja që sidoqoftë nuk mund të jetë më pak se 30 ditë, KfW-ja mund të zgjidhë këtë marrëveshje huaje dhe projekti ose çdo pjesë të saj me pasojën që:

a) detyrimet e saj sipas kësaj marrëveshjeje huaje pushojnë, dhe

b) KfW-ja mund të kërkojë shlyerjen e plotë ose të pjesshme të shumës së prapambetur të huas së bashku me interesin e mbledhur dhe të gjitha shumat e tjera të kërkueshme sipas kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi. Nenet 7.5 (interesi i munguar) dhe 7.6 (kompensimi me shumë të plotë) zbatohen për shumat e përsheptuara *mutatis mutandis*.

12.3 Kompensimi për dëmet. Në rastin kur marrëveshja e huas dhe programit zgjidhet plotësisht ose pjesërisht para se të jetë shlyer plotësisht, Huamarrësi do të paguajë kompensimin e mospranimit në pajtim me nenin 3.6 (kompensimi i mospranimit) dhe/ose kompensimin e parapagimit në pajtim me nenin 6.4 (kompensimi i parapagimit).

### 13. Përfaqësimi dhe deklarimet

13.1 Përfaqësimi i Huamarrësit dhe agjencisë së zbatimit të programit. Ministri i Financave dhe ata persona që caktohen prej tij ose saj për KfW-në dhe autorizohen nëpërmjet ekzemplarëve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj përfaqësojnë Huamarrësin në zbatimin e marrëveshjes së huas dhe programit. Fuqia e përfaqësimit nuk skadon nëse revokimi shprehimisht prej përfaqësuesit të Huamarrësit të autorizuar në momentin përkatës nuk merret prej KfW-së. Drejtori Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe personat e caktuar nga ai/ajo për KfW-në dhe të autorizuar nga ekzemplarët e firmave të vërtetuara nga ai ose ajo, përfaqëson agjencinë e zbatimit të programit në ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi. Fuqitë e përfaqësimit nuk skadojnë derisa revokimi i tyre shprehimisht nga përfaqësuesi të autorizuar në atë kohë nuk është marrë nga KfW-ja.

13.2 Adresat. Njoftimet ose deklarimet në lidhje me këtë marrëveshje huaje dhe programi duhet të jenë me shkrim. Ato duhet të dërgohen në origjinale ose – me përjashtim të kërkesave për disbursime – me faks. Të gjitha njoftimet ose deklarimet e tjera të bëra në lidhje me këtë marrëveshje huaje dhe programi duhet të dërgohen në adresat e mëposhtme:

Për KfW-në:

KfW  
Postfach 11 11 41  
60046 Frankfurt am Main / Germany  
Germany  
Fax: +49 69 7431-2944

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1  
Al-Tirana  
Faks (+355)-4-222 8494

Për agjencinë e zbatimit të programit

Fondi Shqiptar i Zhvillimit  
Rruga “Sami Frashëri”, nr.10  
Al-Tirana  
Faks: (+355) 4-22-34885

#### 14. Dispozita të përgjithshme

14.1 Ditë bankare. Nëse bëhet referencë në këtë marrëveshje huaje dhe programi tek një “ditë bankare”, kjo do të thotë një ditë e ndryshme nga e shtuna ose e diela në të cilën bankat tregtare në Frankfurt mbi Main janë të hapura për punë të përgjithshme.

14.2 Vendi i përmbushjes. Vendi i përmbushjes së të gjitha detyrimeve sipas kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi është Frankfurti mbi Main, Republika Federale Gjermane.

14.3 Pavlefshmëria e pjeshme dhe boshllëqet. Nëse një dispozitë e kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi është ose bëhet e pavlefshme, ose ka një boshllëk në një prej dispozitave të tjera të saj. Palët në këtë marrëveshje huaje dhe programi zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një të vlefshme ligjërishit që është sa më afër që të jetë e mundur me frymën dhe qëllimin e dispozitës së pavlefshme. Palët mbushin çdo boshllëk në dispozitat me një dispozitë ligjërishit të vlefshme që është sa më afër që të jetë e mundur me frymën dhe qëllimin e kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi.

14.4 Forma dhe ndryshimi me shkrim. Ndryshimet dhe shtesat në këtë kontratë duhet të bëhen me shkrim. Çdo heqje dorë nga kjo kërkesë me formë me shkrim duhet të deklarohet nga palët me shkrim. Ndryshimet në këtë marrëveshje huaje dhe programi që cenojnë vetëm marrëdhënien ligjore ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit nuk kërkojnë miratimin e agjencisë së zbatimit të programit.

14.5 Transferimi. As Huamarrësi, as agjencia e zbatimit të programit nuk mund të japin ose transferojnë, rëndojnë me peng ose hipotekë çdo pretendim nga kjo marrëveshje huaje dhe programi.

14.6 Ligji i zbatueshëm. Kjo marrëveshje huaje dhe programi rregullohet nga ligjet e Republikës Federale të Gjermanisë.

14.7 Periudha e parashkrimit. Të gjitha pretendimet e KfW-së sipas kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi parashkruhen pas pesë vjetësh nga fundi i vitit në të cilën ky pretendim ka lindur dhe në të cilën KfW-ja ka marrë dijëni për rrethanat që përbëjnë këtë pretendim ose mund të kishte ardhur në dijëni të tyre pa neglizhencë të theksuar.

#### 14.8 Heqja dorë nga imuniteti

a) Në masën që Huamarrësi tashmë ose në të ardhmen në çdo juridiksion pretendon për vete ose sendet e tij imunitet nga padia, ekzekutimi, sekuestroja ose një masë tjetër ligjore dhe në masën që në një juridiksion të tillë ky imunitet mund t'i jepet vetes së tij ose sendeve të tij, Huamarrësi bie dakord në mënyrë të përvokueshme për të mos pretenduar dhe heq dorë në mënyrë të përvokueshme nga ky imunitet në masën më të gjerë të mundshme të lejuar nga ligjet e këtij juridiksioni.

b) Në çdo rast, Huamarrësi nuk heq dorë nga asnjë imunitet, në lidhje me ekzekutimin për:

i) “ambientet e misionit” të tashme ose të ardhshme të përkufizuara në Konventën e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike të vitit 1961, “ambientet konsullore” të tashme ose të ardhshme të përkufizuara në Konventën e Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore të nënshkruar në vitin 1963 ose që përdoret ndryshe nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë ose një agjenci ose instrument i saj;

ii) çdo pasuri të paluajtshme që rregullohet nga dispozitat e nenit 3, paragrafi 1-3 i ligjit shqiptar nr. 8743, të datës 22/02/2001 “Mbi pasurinë e paluajtshme shtetërore”;

iii) çdo fond monetar dhe/ose shumë që është bërë e kërkueshme dhe është paguar në momentin e ekzekutimit për përmbushjen e detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka sipas traktateve, konventave dhe/ose marrëveshjeve ndërkombëtare të së drejtës publike të nënshkruar prej saj.

#### 14.9 Mosmarrëveshjet ligjore

Arbitrazhi. Të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga ose në lidhje me këtë marrëveshje huaje dhe programi do të zgjidhen vetëm dhe përfundimisht nga një gjykatë arbitrazhi. Në lidhje me këtë, zbatohet sa më poshtë:

a) Gjykata e arbitrazhit përbëhet nga një ose tre arbitra që emërohen dhe veprojnë në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) të ndryshuar herë pas here.

b) Gjykimi në arbitrazh zhvillohet në Frankfurt mbi Main. Gjykimi zhvillohet në gjuhën angleze.

14.10 Transmetimi i informacionit. KfW-ja ka të drejtë t'i transmetojë lëshuesit të garancisë federale të përmendur në nenin 9 dhe Republikës Federale Gjermane informacion në lidhje me përfundimin dhe nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje huaje dhe programi. KfW-ja, lëshuesi i garancisë federale dhe Republika Federale Gjermane kanë të drejtë të kalojnë informacionin në lidhje me huan dhe programin, duke përfshirë dhënien e kontratave për furnizimet dhe shërbimet që financohen nga huaja organizatave ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore, veçanërisht në lidhje me çështjet për shërbimin e borxhit dhe mbledhjen dhe publikimin e të dhënave në lidhje me dhënien e

kontratave për furnizimet dhe shërbimet që financohen nga huaja. E drejta e mësipërme për dhënien e informacionit organizatave ndërkombëtare përfshin edhe të drejtën për të kaluar drejtpërdrejt këtë informacion anëtarëve të këtyre organizatave.

14.11 Hyrja në fuqi. Kjo marrëveshje huaje dhe programi nuk hyn në fuqi derisa marrëveshja qeveritare mbi të cilën ajo bazohet të ketë hyrë në fuqi dhe Huamarrësi të ketë informuar KfW-në me shkrim që marrëveshja e programit dhe huas është ratifikuar dhe ratifikimi i saj është publikuar rregullisht.

Kjo marrëveshje huaje nënshkruhet në 3 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt mbi Main, ..... Tirana, .....

#### ANEKSI 1 GRAFIKU I DISBURSIMIT

Në fund të çdo periudhe të treguar më poshtë, Huamarrësi do të ketë kërkuar disbursimin e shumave të huas që nuk kalojnë në total shumën e treguar më poshtë për secilën periudhë. Në masën që agjencia e zbatimit të projektit kërkon disbursimin e shumave më të vogla brenda çdo periudhe gjashtëmujore, shumat e padisburuara mund të kërkojnë në gjashtëmujorët e ardhshëm pasues.

<b>Të gjitha shifrat në euro</b>	<b>Disbursimi në periudhën aktuale</b>	<b>Disbursimi në periudhat e mëparshme</b>	<b>Disbursimet totale*</b>
1.1.2011-30.06.2011	2,000,000	0	2,000,000
1.7.2011-31.12.2011	3,000,000	2,000,000	5,000,000
1.1.2012-30.6.2012	5,000,000	5,000,000	10,000,000
1.7.2012-31.12.2012	5,000,000	10,000,000	15,000,000
1.1.2013-30.06.2013	5,000,000	15,000,000	20,000,000

\* Shuma totale maksimale e grumbulluar që mund të disbursohet deri në fund të secilës periudhë disbursimi.

## ANEKSI 2

Shënim: Jeni të lutur të ndryshoni “Republika e VENDIT”/ “VENDI” përkatësisht.  
MODEL I MENDIMIT LIGJOR TË KËSHILLTARIT LIGJOR PËR HUAMARRËSIN (SHTETI)  
[Koka e letrës së këshilltarit ligjor]

KfW  
(datë)  
Departamenti [     ] ]  
Në vëmendje të: [                     ] ]  
Palmengartenstrasse 5 - 9  
Postfach 11 11 41  
60325 Frankfurt am Main / Germany

Republika Federale Gjermane

Marrëveshje e huas dhe programit datë ..... dhe lidhur ndërmjet KfW-së (.....) (Huamarrësi) dhe (.....) për një shumë që nuk kalon në tërësi \_\_\_ 000 000 euro,-.

Të nderuar zotërinj,

Unë jam (Ministri i Drejtësisë) (këshilltar ligjor i) (shef i departamentit ligjor) . . . (jeni të lutur të specifikoni ministrinë ose autoritetin tjetër) të Republika e VENDIT. Unë kam vepruar në këtë cilësi në lidhje me marrëveshjen e huas dhe programit (marrëveshja e huas dhe programit), datë . . . , të bërë ndërmjet Huamarrësit (. . . .) dhe jush në lidhje me një hua që do t'i jepet prej jush Huamarrësit në një shumë që nuk kalon \_\_\_000.000,-- euro.

1. Dokumentet e shqyrtuara

Unë kam shqyrtuar:

1.1 një kopje të nënshkruar autentike të marrëveshjes së huas dhe programit;

1.2 dokumentet kushtetuese të Huamarrësit, veçanërisht:

a) Kushtetutën e Republikës së VENDIT, datë . . . . . , publikuar rregullisht në , nr. . . . . , faqe. . . . . , e ndryshuar;

b) ligji (et) nr . . . . . datë . . . . . , të publikuara rregullisht në . . . . . , nr. . . . . , faqe. . . . . , e ndryshuar; (jeni të lutur të fusni, nëse ka, ligje (p.sh, ligjet e buxhetit) në lidhje me marrjen hua të parave nga Republika e vendit);

c). . . . . [jeni të lutur t'u referoheni këtu dokumenteve të tjera, p.sh, dekreteve ose rezolutave të organeve qeveritare ose administrative të VENDIT mbi lidhjen e marrëveshjeve të huave nga VENDI në përgjithësi ose mbi lidhjen e marrëveshjes së huas dhe programit); dhe

d) Marrëveshja e bashkëpunimit financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së VENDIT dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë datë . . . . . (marrëveshja e bashkëpunimit)

dhe ato ligje, rregullore, certifikata, regjistra, të dhëna dhe dokumente dhe janë bërë ato hetime të tjera që i kam çmuar të nevojshme ose të dëshirueshme për qëllimin e dhënies së këtij mendimi.

2. Mendimi

Për qëllimet e nenit ..... të marrëveshjes së huas dhe programit, unë jam i mendimit që sipas ligjeve të republikës së vendit të kësaj date:

2.1 Në pajtim me nenin . . . . . të Kushtetutës / nenit . . . . . të ligjit nr . . . . . (jeni të lutur të specifikoni sipas rastit) Huamarrësi ka të drejtë të lidhë marrëveshjen e huas dhe programit dhe ka marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të autorizuar nënshkrimin, dhënien dhe përmbushjen e marrëveshjes së huas dhe programit, veçanërisht në bazë të:

a) ligji(ve) nr . . . . . datë . . . . . të parlamentit të republikës së VENDIT, që ratifikon marrëveshjen e huas dhe programit/ aprovon nënshkrimin, dhënien dhe përmbushjen e marrëveshjes së huas dhe programit nga Huamarrësi / . . . . . (jeni të lutur të fusni sipas rastit);

b) Rezoluta(t) nr . . . . . datë . . . . . të Kabinetit të Ministrave / të komitetit të huave shtetërore / . . . . . (jeni të lutur të fusni organet qeveritare ose administrative të VENDIT sipas rastit);

c) . . . . . (jeni të lutur të fusni rezoluta, vendime të tjera etj].

2.2 Zj/z. . . . . (dhe zj/z. . . . . )  
është (janë) të autorizuar rregullisht nga . . . . . (p.sh, ligji në sajë të pozicionit të tij/saj (si Ministër i . . . . . /si . . . . . ), nga rezoluta qeveritare. . . . , me prokurë të datës . . . . etj) të nënshkruaj vetëm/bashkërisht marrëveshjen e huas dhe programit në emër të Huamarrësit. Marrëveshja e huas dhe programit e nënshkruar nga zj/z. . . . . (dhe zj/z. . . . . ) është nënshkruar rregullisht nga ana e Huamarrësit dhe përbën një detyrim ligjorisht detyruar për Huamarrësin të ekzekutueshëm ndaj tij ligjorisht në pajtim me termat e saj.

(Alternativa 1 për seksionin 2.3, që përdoret nëse përveç dokumenteve të specifikuar në seksionin 2.1 dhe 2.2 duhet të merren autorizime të caktuara zyrtare sipas ligjeve të Republikës së VENDIT).

2.3 Për nënshkrimin dhe përmbushjen e marrëveshjes së huas dhe programit nga Huamarrësi (duke përfshirë pa kufizim marrjen dhe transferimin tek KfW-ja të të gjitha shumave të kërkueshme në bazë të saj në monedhat e specifikuar në të), janë marrë aprovimet, autorizimet, licencat, regjistrimet dhe/ose pëlqime e mëposhtme zyrtare dhe janë në fuqi të plotë:

a) Aprovimi i . . . . . (banka qendrore/banka kombëtare/. . . . . ], datë . . . . . , nr. . . . . ;

b) Pëlqimi i . . . . . [Ministri / Ministria e . . . . . ], datë . . . . . , Nr. . . . . ; dhe

c) . . . . . (jeni të lutur të rendisni çdo autorizim, licencë dhe/ose pëlqim tjetër zyrtar).

Asnjë autorizim, pëlqim, licencë, regjistrim dhe/ose aprovim tjetër zyrtar i një autoriteti ose agjencie qeveritare (duke përfshirë bankën qendrore/zyrtare të republikës së VENDIT) ose gjykate nuk kërkohet apo është e këshillueshme në lidhje me nënshkrimin dhe përmbushjen e marrëveshjes së huas dhe programit nga Huamarrësi (duke përfshirë pa kufizim marrjen dhe transferimin tek KfW-ja të të gjitha shumave që kërkohen në monedhat e specifikuar atje) dhe vlefshmëria dhe ekzekutueshmëria e detyrimeve të Huamarrësit sipas marrëveshjes së huas dhe programit.

[Alternativa 2 për seksionin 2.3, që përdoret vetëm nëse përveç dokumenteve të specifikuar në seksionin 2.1 dhe 2.2 asnjë autorizim zyrtar nuk duhet të merret sipas ligjeve të Republikës së VENDIT:)

2.3 Asnjë autorizim, pëlqim, licencë, regjistrim dhe/ose aprovim tjetër zyrtar i një autoriteti ose agjencie qeveritare (duke përfshirë bankën qendrore/zyrtare të republikës së VENDIT) ose gjykate nuk kërkohet apo është i këshillueshëm në lidhje me nënshkrimin dhe përmbushjen e marrëveshjes së huas dhe programit nga Huamarrësi (duke përfshirë pa kufizim marrjen dhe transferimin tek KfW-ja të të gjitha shumave që kërkohen në monedhat e specifikuar atje) dhe vlefshmëria dhe ekzekutueshmëria e detyrimeve të Huamarrësit sipas marrëveshjes së huas dhe programit.

2.4 Asnjë tatim vule ose tatim apo detyrim i ngjashëm nuk duhet të paguhet në lidhje me vlefshmërinë ose ekzekutueshmërinë e marrëveshjes së huas dhe programit.

2.5 Zgjedhja e ligjit gjerman për të rregulluar marrëveshjen e huas dhe programit dhe paraqitjen për arbitrazh në pajtim me nenin 14.9 të marrëveshjes së huas dhe programit janë të vlefshme dhe detyruese. Vendimet e arbitrazhit kundër Huamarrësit njihen dhe janë të ekzekutueshëm në republikën e VENDIT në pajtim me rregullat e mëposhtme: . . . . . (jeni të lutur të fusni traktatin e zbatueshëm (sipas rastit) p.sh., në vitin 1958 Konventa e Nju-Jorkut, dhe/ose parimet bazë në lidhje me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit në VEND).

2.6 Gjykatat e republikës së VENDIT kanë drejtën të japin vendime të përcaktuara në monedhën ose monedhat e specifikuar në marrëveshjen e huas dhe programit.

2.7 Huamarrja nga Huamarrësi sipas marrëveshjes së huas dhe programit, si dhe nënshkrimi dhe përmbushja e marrëveshjes së huas dhe programit nga Huamarrësi përbëjnë akte private dhe tregtare, dhe jo akte publike ose qeveritare. As Huamarrësi, dhe asnjë prej sendeve të tij nuk ka të drejtë imuniteti nga arbitrazhi, padia, përmbarimi, sekuestrimi ose veprime të tjera ligjore. Megjithatë, Huamarrësi nuk heq dorë nga imuniteti, në lidhje me ekzekutimin për:

- “ambientet e misionit” të tashme ose të ardhshme të përkufizuara në Konventën e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike në vitin 1961, “ambientet konsullore” të tashme ose të ardhshme të përkufizuara në Konventën e Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore të nënshkruar në vitin 1963 ose që përdoret ndryshe nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë ose një agjenci ose instrument i saj;

- çdo pasuri të paluajtshme që rregullohet nga dispozitat e nenit 3, paragrafi 1-3 i ligjit shqiptar nr.8743, të datës 22/02/2001 “Mbi pasurinë e paluajtshme shtetërore”;

- çdo fond monetar dhe/ose shumë që është bërë e kërkueshme dhe është paguar në momentin e ekzekutimit për përmbushjen e detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka sipas traktateve, konventave dhe/ose marrëveshjeve ndërkombëtare të së drejtës publike të nënshkruar prej saj.

2.8 Marrëveshja e bashkëpunimit është në fuqi të plotë sipas kushtetutës dhe ligjeve të republikës së VENDIT (Në pajtim me nenin 3 të marrëveshjes së bashkëpunimit) (Nëse marrëveshja e bashkëpunimit nuk ka hyrë në fuqi, por ekziston një marrëveshje e tatimit të dyfishtë). Në pajtim me .....(jeni të lutur të specifikoni traktatin ose ligjet e zbatueshme dhe rregulloret), Huamarrësit nuk i kërkohet të bëjë asnjë zbritje ose ndalesë nga pagesa që Huamarrësi duhet të bëjë sipas marrëveshjes së huas dhe programit dhe nëse një zbritje apo ndalesë duhet të vendoset më vonë, dispozitat e nenit 10.1 të marrëveshjes së huas dhe programit zbatohen për t'i kërkuar Huamarrësit të zhdëmtojë përkatësisht KfW-në.

2.9 KfW-ja nuk është dhe nuk konsiderohet të jetë rezidente, me seli apo të zhvillojë biznes apo t'i nënshtrohet tatimit në republikën e VENDIT thjesht për shkak të nënshkrimit, përmbushjes ose ekzekutimit të marrëveshjes së huas dhe programit. Nuk është e nevojshme apo e këshillueshme që KfW-ja të licencohet, kualifikohet apo të marrë të drejtë në mënyrë tjetër të zhvillojë biznes ose që KfW-ja të emërojë agjentë apo përfaqësues në republikën e VENDIT.

Për pasojë, detyrimet e Huamarrësit sipas marrëveshjes së huas dhe programit përbëjnë detyrime të drejtpërdrejta dhe pa kusht, të ligjshme, të vlefshme dhe detyruese për Huamarrësin dhe janë të ekzekutueshme ndaj Huamarrësit në pajtim me termat e tyre përkatës.

Ky mendim ligjor kufizohet për ligjet e republikës së vendit.

.....  
(vendi) (data)

[Nënshkrimi]

Emri:

Bashkëngjitur:

Shënim. Jeni të lutur të bashkëngjisni fotokopje të certifikuara të dokumenteve dhe dispozita ligjore të përmendura më sipër në seksionin 1.2 (a) deri 1.2(c) dhe seksionit 2.1 deri 2.3 dhe 2.8 (në lidhje me ligjet e gjata dhe Kushtetutën e republikës së VENDIT, një kopje të dispozitave përkatëse duhet të jetë e mjaftueshme) dhe t'i japë KfW-së një përkthim të certifikuar në anglisht ose gjermanisht të secilës prej dokumenteve të sipërpërmendura nëse këto dokumente nuk janë lëshuar në anglisht ose gjermanisht si një gjuhë zyrtare.

Fondi Shqiptar për Zhvillim  
Rr. Sami Frashëri, Nr. 10  
Tiranë  
Republika e Shqipërisë

Heike Schwarzl  
Ref jonë.: hsz  
Tel: +49 69 7431 4225  
email: heike.schwarzl@kfw.de  
Datë: 01 Shtator 2010

L III/a4 Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Republikën e Shqipërisë  
Fondi i Investimit Social IV  
20 milionë euro (huaja)  
BMZ-nr: 2010 76 721  
8,820,000 euro (kontributi financiar)

Marrëveshja e veçantë e marrëveshjes së huas dhe programit e datës \_\_\_\_\_  
dhe Marrëveshja e financimit dhe programit për kontributin financiar të dhënë nga Bashkimi Europian, e datës \_\_\_\_\_

Të nderuar zotërinj,

Në pajtim me marrëveshjen e huas dhe programit të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave (Huamarrësi) dhe Fondit Shqiptar për Zhvillim (agjencia e zbatimit të programit) dhe KfW-së (KfW), e datës \_\_\_\_\_ dhe marrëveshjen e financimit të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave (përfituesi) dhe Fondit Shqiptar për Zhvillim (agjencia e zbatimit të programit) dhe KfW-së e datës \_\_\_\_\_ sa më poshtë përcaktohet me marrëveshje të veçantë:

Sipas nenit 1.2 të marrëveshjes së huas dhe programit dhe nenit 1.2 të marrëveshjes së financimit dhe programit:

informacione të hollësishme në lidhje me programin, si dhe mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen nga huaja dhe kontributi financiar;

Sipas nenit 3.4 të marrëveshjes së huas dhe programit dhe nenit 3.1 të marrëveshjes së financimit dhe programit:

procedura e disbursimit, në veçanti të dhënat që provojnë se huaja e disbursuar dhe shumat e kontributit financiar të përdoren për qëllimin e caktuar;

Sipas nenit 11.2 të marrëveshjes së huas dhe programit dhe nenit 7.2 të marrëveshjes së financimit dhe programit:

informacione të hollësishme në lidhje me nenin 11.1 të marrëveshjes së huas dhe programit dhe nenit 7.1 të marrëveshjes së financimit dhe programit.

Ne propozojmë që të bihet dakord sa më poshtë:

I. Planprojekti i programit

1. Informacione të hollësishme në lidhje me programin

Programi trajton rehabilitimin, rindërtimin ose ndërtimin e sistemeve të ujësjellësve ruralë dhe nëse është e zbatueshme, shërbimet bazë të kanalizimeve të ujërave të zeza, si dhe rehabilitimin ose rindërtimin e rrjetit rural rrugor. Qëllimi i programit është përdorimi i aksesit të përmirësuar dhe të qëndrueshëm të popullsisë rurale në zonat e programit (qarqet e Shkodrës, Kukësit dhe Dibrës) në infrastrukturën ekonomike dhe sociale. Kjo do të arrihet nëpërmjet rehabilitimit ose rindërtimit të rrjetit rural rrugor, si dhe rindërtimit ose ndërtimit të ujësjellësit rural me rrjedhje të lirë. Skema kanalizimesh të një shkalle të ulët mund të zbatohen mbi baza pilot. Programi do të kontribuojë në përmirësimin e qëndrueshëm të kushteve të jetesës të popullsisë rurale në rajonet e programit në pjesën veriore të Shqipërisë. Kriteret për arritjen e këtyre objektivave, rezultatet e programit dhe aktivitetet e kërkuara të programit, si dhe kushtet për arritjen e qëllimit të programit dhe rezultatet e programit gjenden në aneksin 1.

Planprojekti i programit bazohet në dokumentet e disponueshme për KfW-në, Huamarrësin dhe agjencinë e zbatimit të programit dhe në marrëveshjet e bëra ndërmjet KfW-së, Huamarrësit dhe agjencisë së zbatimit të programit gjatë vlerësimit lokal të programit në prill 2010 dhe të përcaktuara në procesverbalin e mbledhjes të nënshkruar në qershor 2010.

Aktivitetet e mëposhtme të programit në lidhje me masat infrastrukturore të ujësjellësit rural financohen nga huaja:

- Përzgjedhja e komunave/fshatrave të pranueshme në bazë të kriterëve sociale, ekonomike dhe financiare nëpërmjet studimeve sociale, teknike dhe financiare të fizibilitetit të kryera nga FSHZH-ja;
- Shërbimet e konsulencës për planin e detajuar dhe mbikëqyrjen në terren;
- Rehabilitimi, rindërtimi ose ndërtimi i 20 deri 25 skemave të ujësjellësve ruralë me rrjedhje të lirë (për shembull ujëmbledhësit, linjat e transmetimit, rezervuarët, rrjetet e shpërndarjes, lidhjet në shtëpi etj) sipas standardeve të zhvilluara dhe të zbatuara në RWSP;
- Shërbimet e konsulencës së zbatimit dhe forcimit institucional për të përcaktuar dhe zbatuar masat e lartpërmendura (duke përfshirë planifikimin, strukturën e standardeve, mbështetjen në prokurimin e mallrave dhe shërbimeve, mbikëqyrjen e përgjithshme të punimeve si dhe trajnimin për operatorët e sistemit dhe informimin dhe sensibilizimin e grupit të synuar);
- Trajnimi për forcimin e funksionimit dhe mirëmbajtjes, si dhe kapaciteti tregtar dhe financiar i operatorëve të sistemit;
- Prezantimi i tarifave për mbulimin e kostos së ujit;
- Informimi i grupit të synuar rreth promovimit të tarifës së re;
- Sensibilizimi i grupit të synuar në lidhje me vlerën e ujit dhe higjienën.

Aktivitetet e mëposhtme të programit në lidhje me masat e infrastrukturës rrugore financohen nga huaja dhe kontributi financiar:

- Përzgjedhja përfundimtare e rrugëve (nga lista e plotë aktuale që është miratuar në procesverbalin e mbledhjes së datës 2 qershor 2010, e cila mund të përditësohet dhe zgjerohet) në bazë të studimit të hollësishëm që duhet të kryhet para ose në fillim të programit;
- Rehabilitimi, rindërtimi dhe përmirësimi i deri 100 km rrugë, duke përfshirë masa për sigurinë e rrugëve dhe infrastrukturën përkatëse në shkallë të ulët sipas standardeve të përdorura në projektin aktual të “Rrugëve dytësore dhe lokale” (standardi i ndërmjetëm i FSHZH-së dhe draft manuali shqiptar i projektimit të rrugëve);
- Shërbimet e konsulencës për plan-projektin e detajuar (në rastet kur planprojekti nuk ekziston);
- Konsulenca për prokurimin dhe menaxhimin e kontratave financohet nga donatorë të tjerë por mund të financohet në rast se fondet e donatorëve nuk janë të mjaftueshme;
- Konsulenca për mbikëqyrjen e vendndodhjes;
- Kosto pjesërisht nën administrimin e FSHZH-së.

## 2. Grafiku kohor

Grafiku kohor për përgatitjen, zbatimin dhe funksionimin e programit gjendet në aneksin 2.

## 3. Kostoja totale dhe financimi

Kostoja totale e llogaritur e programit (kostoja totale) për vlerësimin e programit është rreth 30.6 milionë euro. Shuma e huas është 20 milionë euro. Përveç kësaj do të sigurohet një grand i BE-së (kontributi financiar) sipas instrumentit për asistencën ndaj paraaderimit (IPA) 2009 në shumën prej 8,820,000 euro. Përbërja e kostove totale dhe planit të financimit gjendet në aneksin 3.

## 4. Ndryshimet në Planprojekt

Çdo ndryshim thelbësor në planprojekt kërkon pëlqimin paraprak të KfW-së. Agjencia e zbatimit të programit informon KfW-në menjëherë për këtë, duke deklaruar arsyet, masat e planifikuara dhe pasojat e ndryshimit (duke përfshirë ato mbi koston totale). Zbatimi i këtyre masave mund të fillojë vetëm mbi bazën e një planifikimi të rishikuar dhe me pëlqimin e KfW-së.

## II. Zbatimi i programit

### 1. Përgjegjësitë dhe grafiku kohor, i koston dhe i financimit

#### 1.1 Fondi Shqiptar për Zhvillim (FSHZH) është përgjegjës për zbatimin e programit

1.2 Grafiku i detajuar kohor, i koston dhe financimit, i përditësuar rregullisht për zbatimin e duhur teknik dhe financiar të programit, do të përgatitet sa më shpejt që të jetë e mundur nga Fondi Shqiptar për Zhvillim (FSHZH), në bashkëpunim me konsulentin dhe i paraqitet KfW-së dhe është në përputhje me nenin 3 të seksionit I. Ky grafik duhet të tregojë, me afate dhe shumën, ndërlidhjen e synuar kronologjike të aktiviteteve të programit dhe kërkesat rezultuese financiare. Nëse ndonjë devijim nga ky grafik bëhet i nevojshëm gjatë zbatimit të programit, KfW-së do t'i sigurohet një grafik i rishikuar.

### 2. Caktimi i konsulentëve

2.1 a) Detyrat e konsulentit për zbatimin dhe forcimin institucional në lidhje me masat infrastrukturore të ujësjellësit rural mbështesin:



- përcaktimin e përgjithshëm, planifikimin, hartimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e masave për komponentët e ujit;

- prokurimin e punimeve dhe shërbimeve civile;

- përgatitjen e një baze të dhënash të skemave të përshtatshme rurale të ujësjellësit në zonën e programit;

- FSHZH për trajnim për njësitë e qeverisjes lokale (për operimin, mirëmbajtjen, menaxhimin);

- FSHZH në fushatën e informimit dhe sensibilizimit të grupit të synuar;

- administrimin e fondit të disponimi.

b) Detyrat e konsulentit të mbikëqyrjes dhe planprojektit të detajuar në lidhje me masat infrastrukturore të ujësjellësit rural mbështesin:

- planprojektin e detajuar dhe dokumentet e tenderit të skemave të ujësjellësit;

- mbikëqyrjen në terren.

c) Detyrat e konsulentit të plan projektit të detajuar në lidhje me masat infrastrukturore rrugore mbështesin:

- planprojektin,

- vlerësimet e ndikimit mjedisor dhe social.

d) Detyrat e konsulentit për prokurimin dhe menaxhimin e kontratave në lidhje me masat infrastrukturore rrugore (nëse kërkohet) mbështesin:

- prokurimin,

- menaxhimin e kontratave.

e) Detyrat e konsulentit në lidhje me masat infrastrukturore rrugore mbështesin:

- mbikëqyrjen në terren.

2.2 Pas përzgjedhjes paraprake dhe ofertimit ndërkombëtar konkurrues publik për të gjitha shërbimet e konsulencës (me përjashtim të konsulencës së zbatimit dhe forcimit institucional në lidhje me masat infrastrukturore të ujësjellësit rural, shihni II 2.4) kontratat do t'i jepen konsulentëve të pavarur të kualifikuar. Procedura e dhënies së kontratës rregullohet nga "Udhëzimet për caktimin e konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim" (aneksi 4) që formon pjesë përbërëse të saj. Dokumentet e tenderit përfshijnë një deklaratë që pranueshmëria e ofertuesve, ndër të tjera, do t'i nënshtrohet verifikimit nga Bashkimi Europian (BE) në bazë të sistemit të brendshëm të njoftimit paraprak të BE-së.

Shërbimet e konsulencës për plan projektin e detajuar të rrugëve (në rastet kur plan projekti nuk ekziston) përfshihen në tenderin e BERZH/EIB-it (pjesa e kontratës që mbulon shërbimet për rrugët e financuara nga KfW-ja do të nënshkruhet pas lidhjes së marrëveshjes së huas dhe financimit ndërmjet FSHZH-së, Ministrisë së Financave dhe KfW-së); FSHZH do të mbajë KfW-në të informuar rreth tenderit. Në rast se tenderi i BERZH/EIB-it nuk është në përputhje me udhëzimet e KfW-së, do të ndërmerret një tender i veçantë.

Konsulenca e mbikëqyrjes në terren synohet të përfshihet në tenderin e BERZH/EIB-it në rast se BERZH/EIB ndërmerr një tender të ri për këto shërbime. Deri në përfundimin e detyrës së konsulentit aktual të mbikëqyrjes së vendndodhjes, Luis Berger (i financuar nga Banka Botërore), shërbimet e tij do të përdoren për implementimin e rrugëve të financuara nga KfW-ja.

2.3 Në njoftimin e parakualifikimit ose-nëse nuk është kryer asnjë parakualifikim- në ftesën për tendera, Agjencia e Zbatimit të Programit do të detyrojë ofertuesit të paraqesin së bashku me dokumentet e ofertimit ose së bashku me ofertën, një deklaratë sipërmarrjeje të nënshkruar rregullisht (aneksi 4, faqe 16).

2.4 Konsulenti që tashmë ka një detyrë sipas projektit aktual të ujësjellësit rural do të kërkohet të ofrojë shërbimet e përmendura në pikën II. 2.1 a) më sipër, përveç detyrave sipas projektit të ujësjellësit rural. Angazhimi i konsulentit kërkon pëlqimin paraprak të KfW-së. Për këtë qëllim, KfW-së do t'i jepet në kohën e duhur projekt kontrata, dokumentet për kualifikimet e ekspertëve të zgjedhur për programin, oferta teknike dhe financiare dhe i gjithë dokumentacioni tjetër përkatës që mund të kërkojë KfW-ja.

3. Dhënia e kontratave për mallra dhe shërbime të tjera

3.1 Kontratat për mallra dhe të gjitha shërbimet e tjera jepen në bashkëpunim me konsulentin me anë të ofertimit ndërkombëtar konkurrues.

3.2 Dokumentet e tenderit do t'i paraqiten KfW-së për praninë në kohën e duhur, para publikimit të ftesës për tender.

3.3 Periudha e ofertimit caktohet në mënyrë që t'u japë ofertuesve kohë të mjaftueshme për të përgatitur ofertat e tyre.

3.4 Informacionet e tjera të hollësishme në lidhje me procedurën e dhënies së kontratës dhe dispozitat kontraktuale shpjegohen në "Udhëzimet për prokurimin e kontratave të furnizimit dhe punimeve sipas bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim" (aneksi 5) që formon pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje.

3.5 Në njoftimin e parakualifikimit ose- nëse nuk është kryer asnjë parakualifikim- në dokumentet e tenderit, agjencia e zbatimit të programit do të detyrojë ofertuesit të paraqesin së bashku me dokumentet e parakualifikimit ose së bashku me ofertën, një deklaratë sipërmarrjeje (aneksi 5, faqe 27).

3.6 Në lidhjen e kontratave për mallra dhe shërbime që duhet të financohen nga huaja dhe kontributi financiar, agjencia e zbatimit të programit respekton parimet e mëposhtme:

a) Ndërsa asnjë taksë importi nuk mund të financohet nga huaja dhe kontributi financiar sipas nenit 1.3 të marrëveshjes së huas dhe programit, këto taksa importi, nëse janë pjesë e vlerës së kontratës, do të deklarohen veçmas në kontratat për mallrat dhe shërbimet dhe në fatura.

b) Nëse pagesat e kërkueshme sipas kontratave për mallra dhe shërbime duhet të bëhen nga huaja dhe kontributi financiar, kontratat e lartpërmendura do të përfshijnë një klauzolë që përcakton se çdo rimbursim, garanci ose pagesa të ngjashme të kërkueshme dhe çdo pagesë sigurimi do të bëhet për llogari të agjencisë së zbatimit të programit në llogarinë nr.38 000 000 00 (IBAN: DE53 5002 0400 3800 0000 00) në KfW, Frankfurt am Main (BIC: KFWIDEFF; BLZ 500 204 00), me KfW-në që krediton këto pagesa në llogarinë e Huamarrësit. Nëse këto pagesa bëhen në monedhën lokale, ato do të bëhen në një llogari të veçantë të agjencisë së zbatimit të programit në vendin e agjencisë së zbatimit të programit, që mund të tërhiqen vetëm me miratimin e KfW-së. Këto fonde mund të ripërdoren për zbatimin e projektit me pëlqimin e KfW-së.

3.7 Para lidhjes së një kontrate për mallra dhe shërbime, KfW-së do t'i jepen për pranim projekt kontratat e miratuara, të siguruara me vizat e konsulentëve. Kjo aplikohet edhe për çdo marrëveshje të mëtejshme ndryshuese ose modifikuese.

#### 4. Caktimi i një audituesi

4.1 Një audit vjetor për shfrytëzimin e kontributit financiar të dhënë nga Bashkimi Europian dhe për fondin e disponimit do të kryhet sipas programit.

4.2 Audituesi për shfrytëzimin e kontributit financiar të dhënë nga Bashkimi Europian do të përzgjidhet pas ofertimit konkurrues ndërkombëtar dhe çdo vit do të provojë përdorimin e duhur të kontributit financiar të dhënë nga Bashkimi Europian deri në përfundimin e Programit. Audituesi i fondit të disponimit mund të përzgjidhet sipas procedurave të zbatueshme të agjencisë së zbatimit të programit.

4.3 Audit vjetor për fondin e disponimit (në pajtim me termat e referencës së KfW-së për audituesit, shihni aneksin 6, shtojca C) do të financohet nga fondet e agjencisë së zbatimit të programit. Audit i kontributit financiar (në pajtim me termat e referencës në aneksin 7) i dhënë nga Bashkimi Europian do të financohet nga kontributi financiar. Në rast se audituesi është përzgjedhur pas ofertimit konkurrues ndërkombëtar, të dyja auditet mund të kryhen nga i njëjti auditues.

#### 5. Marrëveshjet e veçanta të zbatimit

5.1 FSHZH do të përgatisë një listë të re të plotë të fshatrave që mund të jenë të pranueshme për të marrë pjesë në komponentin e ujësjellësit rural.

5.2 Para nënshkrimit të kontratave të punimeve, secila komunë e programit do të provojë të drejtat e saj të pakufizuara për operimin e skemave të ujësjellësit që duhet të financohet sipas programit, duke përfshirë të drejtat për mbledhjen dhe sigurimin e ujit (në rastet kur kjo nuk është e mundur marrëveshjet përfundimtare të investimit për skemat e ujësjellësit do të detyrojnë njësinë e qeverisjes vendore të respektojë ligjet dhe rregulloret shqiptare).

5.3 Për një periudhë prej dy vjetësh pas përfundimit të ndërtimit, FSHZH do të inspektojë dy herë në vit skemat e ujësjellësit të financuara nga KfW-ja. Rezultatet e inspektimit do t'i paraqiten publikisht NJQV-së dhe popullatës.

5.4 Procedura e përzgjedhjes për skemat e ujësjellësit rural dhe për rrugët, siç është përshkruar në aneksin 9, formojnë pjesë përbërëse të marrëveshjes së veçantë.

#### 6. Kushtet për Mirëfunksionimin e Programit

Për të garantuar mirëfunksionimin e programit, agjencia e zbatimit të programit do të paraqesë një koncept operimi dhe mirëmbajtjeje të hartuar në bashkëpunim me konsulentin, maksimumi tre muaj pas marrjes paraprake të masës përkatëse infrastrukturore (nënprojekti).

### III. Lista e mallrave dhe shërbimeve dhe procedura e disbursimit

#### 1. Lista e mallrave dhe shërbimeve

1.1 Lista e mallrave dhe shërbimeve që duhet të financohen nga huaja dhe kontributi financiar do të përgatitet mbi bazën e kontratave të lidhura për këto mallra dhe shërbime. Rrjedhimisht, KfW-së do t'i jepet një origjinal ose kopje e secilës prej kontratave të lartpërmendura dhe të çdo kontrate përkatëse ndryshuese.

1.2 Nëse ndonjë masë programi duhet të realizohet për fuqinë punëtore të kontraktuar dhe nuk është lidhur asnjë kontratë, KfW do të marrë në vend të kontratave një grafik të masave të planifikuara, të detajuar në bazë të kategorive kryesore të kostos (grafiku i masave për fuqinë punëtore të kontraktuar). Kostot e shkaktuara për administrimin e përgjithshëm në lidhje me fuqinë punëtore të kontraktuar nuk duhet të përfshihen në grafikun e lartpërmendur të masave për fuqinë punëtore të kontraktuar.

1.3 KfW-ja informon, me kërkesë, agjencinë e zbatimit të programit, për shumatat e huas dhe kontributit financiar që ka rezervuar për financim (lista e mallrave dhe shërbimeve).

#### 2. Procedura e disbursimit

Disbursimi rregullohet nga rregulloret e përcaktuara në aneksin nr.6 (procedura e disbursimit) që formon pjesë përbërëse të kësaj marrëveshjeje.

Kontributi financiar i dhënë nga Bashkimi Europian do të përdoret vetëm për financimin e kontratave që janë dhënë pas ofertimit konkurrues ndërkombëtar. Pagesat sipas këtyre kontratave disbursohen proporcionalisht nga kontributi financiar i ofruar nga Bashkimi Europian dhe huaja e dhënë sipas Bashkëpunimit Financiar Gjerman për këto kontrata, nëse nuk bihet dakord ndryshe ndërmjet KfW-së dhe agjencisë së zbatimit të programit.

### IV. Raportimi dhe dispozita të tjera

#### 1. Raportimi

1.1 Deri në një njoftim të mëtejshëm, agjencia e zbatimit të programit do t'i raportojë KfW-së çdo tre muaj progresin e programit (raportet e progresit), duke përfshirë përmbushjen e marrëveshjeve të zbatimit të përcaktuara në nenin 11.1 h) dhe 11.4 b) të marrëveshjes së huas dhe programit dhe nenin 7.1 g) dhe 7.4 b) të marrëveshjes së programit dhe financimit dhe zhvillimin e të gjitha kushteve të tjera kryesore të përgjithshme. Raporti përfshin pikat e renditura në aneksin 8. Për më tepër, agjencia e zbatimit të programit do të raportojë në lidhje me të gjitha rrethanat që mund të rrezikojnë arritjen e objektivit të përgjithshëm, qëllimin dhe rezultatet e programit. Në kohën e përfundimit fizik dhe vënies në funksionim të programit por para maksimumi skadimit të periudhës së garancisë, Agjencia e zbatimit të programit do të paraqesë një raport përfundimtar në lidhje me masat e realizuara. Raporti i parë mbi gjendjen aktuale do të paraqitet çdo tre muaj pas fillimit të programit. Raportet duhet të jenë marrë nga KfW-ja jo më vonë se katër javë pas përfundimit të periudhës nën rishikim. Raportet do të siglohen nga konsulentit.

1.2 Nëse agjencia e zbatimit të programit ka ngarkuar konsulentin të hartojë raportet e progresit dhe/ose raportin përfundimtar, agjencia e zbatimit të programit do të komentojë në lidhje me raportet ose do të konfirmojë pëlqimin e saj për përmbajtjen me anë të siglimit të raporteve përkatëse.

1.3 Pas përfundimit të programit, agjencia e zbatimit të programit do të raportojë zhvillimin e tij të mëtejshëm (shihni aneksin 8 për informacione të hollësishme). KfW-ja do të informojë agjencinë e zbatimit të programit në kohën e duhur në lidhje me përfundimin e periudhës së raportimit që nuk do të jetë më vonë se katër vjet pas disbursimit të fundit.

#### 2. Klauzola të tjera

2.1 Agjencia e zbatimit të programit i dërgon KfW-së të gjithë dokumentet e nevojshme për KfW-në për të dhënë komente dhe aprovimet e përmendura më sipër ose në udhëzimet e bashkëlidhura, brenda një kohe të shpejtë për të ofruar kohë të arsyeshme për shqyrtim

2.2 Agjencia e zbatimit të programit përgatit pllakate të programit që përmbajnë të paktën mesazhin e mëposhtëm:

“Një program zhvillimi i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Shqiptar për Zhvillim, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Europian dhe Republika Federale e Gjermanisë nëpërmjet KfW-së”

Një vulë programi e dhënë nga ambasada gjermane dhe logoja europiane (dymbëdhjetë yje të verdhë mbi një sfond bojë qielli) vendoset në pllakatin e programit.

2.3 Të gjitha mjetet dhe pajisjet e prokuruar nga konsulenti për programin do të transferohen pranë agjencisë së ekzekutimit të programit pas përfundimit të programit. Provat dokumentuese të transferimit do të ruhen nga agjencia e zbatimit të programit deri në pesë vjet pas përfundimit të programit".

2.4 Agjencia e zbatimit të programit garanton që të gjitha dokumentet e përgatitura nga konsulenti të përfshijnë një referencë ndaj faktit që programi bashkëfinancohet nga Bashkimi Europian dhe paraqet logon europiane (dymbëdhjetë yje mbi një sfond bojë qielli). Kjo aplikohet edhe për mjetet dhe pajisjet që janë prokuruar nga konsulenti për programin derisa ato të jenë transferuar tek agjencia e zbatimit të programit pas përfundimit të programit.

2.5 Agjencia e zbatimit të programit do të publikojë informacionet e hollësishme të mëposhtme të të gjitha kontratave që financohen sipas kësaj marrëveshjeje në faqen e saj të internetit: titulli dhe tipi i kontratës, adresa dhe kombësia e kontraktorit, shuma e kontratës.

2.6 Agjencia e zbatimit të programit garanton se i gjithë dokumentacioni në lidhje me përgatitjen dhe zbatimin e programit të vihet në dispozicion për auditim deri të paktën 6 vjet pas disbursimit të fundit të programit. Agjencia e zbatimit të programit do të garantojë gjithashtu që Komisioni Europian ose përfaqësues të tij të jenë të aftë të kryejnë vlerësimet e programit para, gjatë ose pas zbatimit të tij.

2.7 Dispozitat e mësipërme mund të ndryshohen ose modifikohen në çdo kohë me pëlqim të ndërsjellë, nëse kjo duhet të jetë e dobishme për zbatimin e programit ose ekzekutimin e marrëveshjes së huas dhe programit dhe marrëveshjes së financimit dhe programit. Në të gjitha aspektet e tjera, dispozitat e neneve 13.2 dhe 14 të marrëveshjes së huas dhe programit dhe dispozitat e neneve 6.2, 6.3 dhe 8 të marrëveshjes së financimit dhe programit, për rrjedhojë, zbatohen për këtë marrëveshje.

Ju lutem konfirmoni pëlqimin tuaj për marrëveshjen e mësipërme, duke nënshkruar në formë ligjërishit detyruese dhe duke kthyer kopjet e bashkëlidhura.

Ju lutem i përcillni konsulentit në kohën e duhur një kopje të kësaj shkrese.

Me respekt,  
KfW

Anekset

Aneksi 1: Objektivat dhe rezultatet e programit dhe kushtet për arritjen e tyre

Aneksi 2: Grafiku kohor

Aneksi 3: Kostoja totale dhe financimi

Aneksi 4: Udhëzime për caktimin e konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim

Aneksi 5: Udhëzime për prokurimin e kontratave të furnizimit dhe punimeve sipas bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim

Aneksi 6: Procedura e disbursimit

Aneksi 7: Termat e referencës për audituesit e kontributit financiar të BE-së

Aneksi 8: Përmbajtja dhe forma e raportimit

Aneksi 9: Procedura e përzgjedhjes e skemave të ujësjellësit rural

Lexuar dhe rënë dakord:

Tiranë,

**ANEKSI 1**  
**FONDI I INVESTIMIT SOCIAL IV**  
**INFORMACIONE TË HOLLËSISHME NË LIDHJE ME PROGRAMIN**

Zhvillimi i përgjithshëm – objektivat e politikës  
 Kontributi ndaj përmirësimit të qëndrueshëm të kushteve të jetesës së popullsisë rurale në rajonet pjesëmarrëse në program të pjesës veriore të Shqipërisë

**Objektivi i programit**  
 Aksesit i përmirësuar dhe i qëndrueshëm i popullsisë rurale në ekonomi dhe infrastrukturë sociale nëpërmjet rehabilitimit ose rindërtimit të rrjetit të rrugëve rurale si dhe aksesit i përmirësuar dhe i qëndrueshëm në ujë dhe energji elektrike dhe sigurt nëpërmjet rehabilitimit ose rindërtimit të skemave të ujësjellësit rural me rrjedhje të lirë në tarifa që mbulojnë kostot të pranuar nga pikëpamja sociale

**Treguesit e objektivit të programit**  
 Trafiku i rregulluar gjatë gjithë periudhës së vitit të rrugëve rurale të rehabilituara ose të rindërtuara  
 Mirëmbajtje e shpeshtë për rrugët rajonale të financuara  
 Reduktimi mesatar i kohës së udhëtimit në 40%  
 Furnizimi i vazhdueshëm (24 orë/d) i sigurt (standardet e OBSH-së) me ujë të pijshëm në fshatrat pjesëmarrëse në program  
 Mbulimi i kostove rrjedhëse, duke përfshirë mirëmbajtjen e duhur të skemave të ujësjellësve

**Rreziqet**  
 Njësitë e qeverisë vendore nuk marrin përsipër në nivel të mjaftueshëm përgjegjësitë e tyre të rëna dakord: financimi dhe pajisja me personel për mirëmbajtje të mjaftueshme  
 Kushtet ekstreme të motit në rajonet malore mund të pengojnë përdorimin gjatë gjithë periudhës së vitit  
 Rritjet e tarifave të nevojshme në lidhje me kompensimin e kostos nuk janë miratuar nga njësitë e qeverisjes vendore dhe/ose njësitë rregullatore e ujit  
 Shkëmbimi/qarkullimi i personelit të trajnuar të njësisë së qeverisjes vendore në nivel operacional  
 Reformat e sektorit të transportit janë të vonuara  
 Ujësjellësi rural nuk merret parasysh mjaftueshëm në proceset e reformave për sektorin e ujit

**Objektivi i projektit**  
 Përdorimi i infrastrukturës së rehabilituar dhe të rindërtuar  
 Të rrugëve rurale si dhe përdorimi i skemave të ujësjellësve ruralë të rehabilituar dhe të rindërtuar me rrjedhje të lirë në tarifa që mbulojnë kostot të pranueshme nga pikëpamja sociale

**Treguesit e objektivit të projektit**  
 Rritja proporcionale në volumin e trafikut me 10% në rrugët rurale të rehabilituara ose të rindërtuara një vit pasi seksioni i rrugëve të jetë përmirësuar ose rehabilituar

**Rreziqet**  
 Vonesë në zbatimin e masave (komponenti i ujit) për shkak të vonesës në pagesë të kontributit përfitues ose  
 Vonesë në zbatimin e masave (komponenti i ujit) për shkak të fshatrave që vendosin të tërhiqen pas nënshkrimit të Angazhimit/marrëveshjes paraprake të investimit  
 Vonesë në zbatimin e masave për shkak të kapacitetit të kufizuar të agjencisë së zbatimit të projektit  
 Vonesë në zbatimin e masave për shkak të kushteve ekstreme të motit në rajonet malore  
 Konsumatorët nuk janë të gatshëm dhe të aftë të paguajnë tarifën e miratuar të ujit  
 Çmimet e lëndës djegëse nuk mbeten të përballeshme

Rezultati 1 Deri në 20 skema të ujësjellësve ruralë me rrjedhje të lirë janë instaluar dhe janë funksionale	Rezultati 2 Operatorët e skemave të ujësjellësve ruralë me rrjedhje të lirë janë të aftë të operojnë dhe mirëmbajnë skemat e ujit	Rezultati 3 Grupi i synuar është ndërgjegjësuar për aspektet e higjienës, shëndetit dhe ato operacionale të ujësjellësit dhe kanalizimeve	Rezultati 4 Deri në 100 km rrugë rurale janë rehabilituar ose rindërtuar	Rezultati 5 Agjencia e Zbatimit të Projektit është e trajnuar/e aftësuar për të trajnuar personelin operacional në lidhje me mirëmbajtjen dhe për të kryer sensibilizimin përkatës për programin si dhe fushata të ndërgjegjësimit publik
Studime fizibiliteti Përzgjedhja përfundimtare e masave Planifikimi i detajuar për planprojektin dhe procedurat e tenderimit Punimet e rehabilitimit ose ndërtimit të sistemeve të ujësjellësve ruralë me rrjedhje të lirë (kanalizimet)	Forcimi i operimit dhe nevojave të kapacitetit të mirëmbajtjes së tarifës së re Forcimi i kapacitetit tregtar dhe financiar Prezantimi i tarifave të ujit për kompensimin e kostos	Informacion rreth promovimit Sensibilizimi në lidhje me vlerën e ujit dhe higjienës	Përzgjedhja përfundimtare e masave Planifikimi i detajuar për plan projektin dhe procedurat e tenderit Punimet e rehabilitimit ose rindërtimit Ndërtimi i infrastrukturës plotësuese në shkallë të ulët si për shembull urat, kanalet dhe muret mbajtëse	Vlerësimi i trajnimit të FSHZH-së në lidhje me trajnimin e trajnerëve Trajnimi i personelit të FSHZH-së

Aktivitetet në lidhje me disa rezultate:

Konsulenca për planprojektin, tenderimin dhe mbikëqyrjen për zbatimin e komponentit të ujit

Konsulenca për planprojektin, tenderimin dhe mbikëqyrjen për zbatimin e komponentit të rrugës

Konsulenca për trajnimin

<p>Rreziqet në lidhje me arritjen e rezultateve Numri i mjaftueshëm i komunave/fshatrave që plotësojnë kriteret e programit</p>
---

ANEKSI 2  
FONDI I INVESTIMIT SOCIAL IV  
GRAFIKU KOHOR I PROGRAMIT

Viti	1				2				3				4			
Semestrat	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4
Faza e përgatitjes për zbatimin e programit	■	■	■													
Ndërtimi			■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
Masat e trajnimit dhe sensibilizimi dhe fush e ndërgjegjë publik																
Përgjëgj. për difekte													■	■	■	■

Viti i referohet vitit kalendarik. Grafiku kohor duhet të përshtatet veçanërisht në lidhje me ndërtimin pasi kushtet e motit në rajonin malor mund të pengojnë dhe/ose ndërpresin punimet. Masat e trajnimit dhe sensibilizimit si dhe fushatat e ndërgjegjësimit publik do të kryhen me ndërprerje gjatë të gjithë kohës operative të programit.

ANEKSI 3  
FONDI I INVESTIMIT SOCIAL IV: KOSTOJA TOTALE DHE FINANCIMI

Masat	SIF IV	Kostoja		Financimi	
		Kostoja për kategori në milionë euro	Huaja e bashkëpunimit financiar	Fondet e grantit IPA 2009	Kontributi lokal
<b>Komponenti i masave të rrugëve</b>					
Rehabilitimi dhe ndërtimi i deri 100 km		19.5	11.5	8,0	
Plan projekti i detajuar dhe procedura mjedisore		0.4		0,4	
Mbikëqyrja		1.1	1.1		
Prokurimi dhe menaxhimi i kontratave *		0.2	0.2		
Kostoja e administrimit e FSHZH-së		0.9	0.3		0.6
Të paparashikuara		2.3	1.9	0,4**	
<b>Komponenti total i rrugëve</b>		<b>24.4</b>	<b>15.0</b>	<b>8.8</b>	<b>0.6</b>
<b>Komponenti i masave për ujin</b>					
Ndërtimi i deri 20 - 25 ujësjellësve		4.1	3.5		0.6
Plan projekti i detajuar dhe mbikëqyrja në terren		0.36	0.36		
Kostot e administrimit të FSHZH-së		0.37	0.17		0.2
Konsulenti ndërkombëtar i zbatimit (duke përfshirë mbështetjen institucionale)		0.5	0.5		
Të paparashikuara		0.47	0.47		
<b>Komponentët totalë të ujit</b>		<b>5.8</b>	<b>5.0</b>		<b>0.8</b>
<b>Komponenti i rrugës dhe ujit në SIF IV Total</b>		<b>30.2</b>	<b>20.0</b>	<b>8.8</b>	<b>1.4</b>
<b>Komponentët e trajnimit për të dy komponentët***</b>		<b>0.4</b>	<b>0.4</b>		
<b>SIF IV totale, duke përfshirë trajnimin</b>		<b>30.6</b>	<b>20,4</b>	<b>8.8</b>	<b>1.4</b>

\*Duke supozuar se një kontratë për prokurimin dhe menaxhimin e kontratave do të nevojitet për një vit.

\*\* Duke përfshirë financimin për auditimin e fondeve të IPA-s.

\*\*\*Fondet e grantit për komponentin e trajnimit do të kërkojnë veçmas.



ANEKSI 4  
FONDI I INVESTIMIT SOCIAL IV

UDHËZIME PËR CAKTIMIN E KONSULENTËVE NË BASHKËPUNIMIN FINANCIAR ME  
VENDET NË ZHVILLIM

[http://www.KfW-entwicklungsbank.de/DE\\_Home/Service\\_und\\_Dokumentation/Online\\_Bibliothek/PDF-Dokumente\\_Richtlinien/Consultingrichtlinie E 11 200615701.pdf](http://www.KfW-entwicklungsbank.de/DE_Home/Service_und_Dokumentation/Online_Bibliothek/PDF-Dokumente_Richtlinien/Consultingrichtlinie_E_11_200615701.pdf)

ANEKSI 5  
FONDI I INVESTIMIT SOCIAL IV

UDHËZIME PËR PROKURIMIN E KONTRATAVE TË FURNIZIMIT DHE PUNIMEVE SIPAS  
BASHKËPUNIMIT FINANCIAR ME VENDET NË ZHVILLIM

[http://www.KfW-entwicklungsbank.de/DE\\_Home/Service\\_und\\_Dokumentation/Online\\_Bibliothek/PDF-Dokumente\\_Richtlinien/Vergaberichtlinie E 05 2007.pdf](http://www.KfW-entwicklungsbank.de/DE_Home/Service_und_Dokumentation/Online_Bibliothek/PDF-Dokumente_Richtlinien/Vergaberichtlinie_E_05_2007.pdf)

ANEKSI 6  
PROCEDURA E DISBURSIMIT

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë  
Marrëveshja e huas/financimit/projekti/programit e KfW-së  
Emri i projektit/programit: Fondi i Investimit Social IV (SIF IV)  
Huaja- 20 milionë euro  
Referenca e KfW- nr.: 2010 65 721  
8,820,000 euro – Kontributi financiar (EU – Instrumenti për asistencën për paraaderim (IPA))  
Referenca e KfW-së nr: XXXXX

Hyrje

Ky aneks përcakton procedurën e disbursimit për projektin/programin e lartpërmendur. Marrëveshja e veçantë, duke përfshirë këtë aneks, i vihet në dispozicion të gjithë personelit të huamarrësit, përfituesit ose agjencisë së zbatimit të projektit/programit (pala e autorizuar) dhe çdo pale tjetër të përfshirë në disbursime.

KfW disburson huat dhe kontributet financiare të pakthyeshme (fondet), me kërkesën e palës së autorizuar, në përputhje me ecurinë e projektit/programit të financuar. KfW mbikëqyr përdorimin kontraktual të fondeve që ka rezervuar për mallrat dhe shërbimet specifike mbi bazën e “Marrëveshjes së veçantë” në lidhje me marrëveshjen e huas/financimit/projektit/programit. Lista e mallrave dhe shërbimeve si dhe fondet korresponduese të rezervuara formojnë kështu kuadrin brenda të cilit pala e autorizuar mund të kërkojë disbursim nga KfW-ja pas plotësimit të të gjitha kushteve kontraktuale për disbursim.

Dispozita të përgjithshme

Të gjitha kërkesat për tërheqje

-tregojnë numrin e referencës së KfW-së,

-numërtohen në mënyrë të njëpasnjëshme dhe

-firmosen nga përfaqësuesit e palës së autorizuar që është caktuar si i Autorizuar ndaj KfW-së dhe të cilit KfW-ja i ka marrë ekzemplarë firmash (shembull, shihni shtojcën A).

Në përgjithësi, KfW-ja pranon vetëm kërkesat origjinale të tërheqjes. Nëse në raste të veçanta një kërkesë për tërheqje është transmetuar me faks, origjinali duhet të dërgohet me postë menjëherë pas shënimit si konfirmim faksi. Pala e autorizuar e liron KfW-në nga përgjegjësia për dëme që shkaktohen nga transmetime të rreme, në veçanti për shkak të transmetimeve të gabuara, abuzimit, keqkuptimit ose gabimeve.

Për pagesat e bëra në një monedhë të ndryshme nga monedha e angazhuar (monedha e huaj), KfW do t'i debitojë huamarrësit ose përfituesit këtë shumë që është shpenzuar nga KfW-ja për procurimin e monedhës së huaj, duke përfshirë shpenzimet e paparashikuara.

KfW-ja nuk do të jetë përgjegjëse për vonesat e shkaktuara nga institucionet bankare transferuese në disbursimin ose dërgimin e fondeve. Nëse vonesat shkaktohen nga KfW-ja, përgjegjësia e saj do të kufizohet në pagesën e interesit të shtuar.

Dispozita të veçanta

Pala e autorizuar është Fondi Shqiptar për Zhvillim (FSHZH).

Procedura që duhet të zbatohet

Fondet e caktuara për shërbimet e konsulencës të specifikuar në marrëveshjen e veçantë I.1. + I.3 disbursohen sipas procedurës së drejtpërdrejtë të disbursimit.

Fondet e caktuara për kostot e administrimit të FSHZH-së, studimet socio-ekonomike të fizibilitetit, plan projektin e detajuar dhe mbikëqyrjen në terren, të përcaktuara në marrëveshjen e veçantë i.1. + i.3 dhe zërat e tjerë që duhet të miratohen reciprokisht, disbursohen sipas procedurës së fondit të disponimit (llogaria e veçantë). Kontrata/masat specifike që duhet të financohen nga fondi i disponimit nuk kalojnë shumën prej 350,000 euro ose ndonjë shumë të barazvlefshme.

Kontratat/masat specifike të cilat nuk kalojnë shumën prej 350.000 euro, si dhe fondet e mbetura të investimit të specifikuar në marrëveshjen e veçantë I1 +I.3 disbursohen sipas procedurës së drejtpërdrejtë të disbursimit.

Kontributi financiar i dhënë nga Bashkimi Europian shfrytëzohet për financimin e kontratave për mallra dhe shërbime që janë dhënë pas ofertimit konkurrues ndërkombëtar. Pagesat sipas këtyre kontratave disbursohen *pari passu* nga kontributi financiar i dhënë nga Bashkimi Europian dhe huaja e siguruar sipas Bashkëpunimit Financiar Gjerman për këto kontrata.

Procedura e drejtpërdrejtë e disbursimit (konsulenti)

Pala e autorizuar do t'i dërgojë KfW –së një kërkesë tërheqjeje të nënshkruar rregullisht (shihni shtojcën d) me emrin e përfituesit dhe udhëzimet e pagesës (informacione të plota bankare).

Dokumentet që mbështesin kërkesën për tërheqje, kurdoherë që është e zbatueshme:

- Kopje e faturës së konsulentit

- Të dhëna mbi bazat e rëna dakord në kontratë për llogaritjen e çmimit në rast të rritjes së çmimit

- Lista e shpenzimeve për kostot e rimbursueshme me datën, përshkrimin, çmimin, normën e shkëmbimit të shpenzimeve, të nënshkruara rregullisht nga konsulenti, që deklarojnë se informacioni i dhënë është i vërtetë dhe i saktë.

Dokumentet

Të gjitha të dhënat dokumentuese origjinale të shpenzimeve që i korrespondojnë faturave duhet të ruhen deri të paktën pesë vjet pas përfundimit të masave financiare dhe do të duhet të jenë të munduara të inspektohen në çdo kohë nga KfW-ja ose palë të treta të autorizuara për këtë nga KfW-ja (për shembull, audituesit) ose do t'i dërgohen me kërkesë, KfW-së ose palëve të treta të autorizuara nga KfW-ja.

Operimi i fondit të disponimit (llogaria/të e veçantë/a)

Për qëllim të fondit të disponimit, do të hapet një llogari e veçantë në emër të FSHZH-së (pala e autorizuar). Informacione të hollësishme gjenden në pikën 1 të “kushteve plotësuese” të bashkëlidhura të KfW-së për pagesa, sipas procedurës së fondit të disponimit “kushtet plotësuese” (shtojca B). Parakushtet për disbursime përcaktohen në pikën 2 të “kushteve plotësuese”.

Llogaria duhet të mbahet në euro dhe me normë interesi. Në rast se do të jetë më efektive bërja e pagesave lokale nga një llogari lokale, kjo llogari do të mbahet më tej si llogari e veçantë lokale. Për të shmangur humbjet në zhvlerësimin e monedhës, vetëm shpenzimet e planifikuara për një periudhë një mujore të nevojshme lejohen të transferohen nga llogaria e mësipërme e veçantë në llogarinë e veçantë të monedhës lokale.

Pala e autorizuar informon KfW-në që të paguajë një depozitë fillestare (parapagim) në llogarinë që zotëron pala e miratuar, deri në një shumë që mbulon shpenzimet për një periudhë katërmujore. Shuma aktuale që duhet të disbursohet i nënshtrohet paraqitjes së një parashikimi nga pala e autorizuar, e shpenzimeve të planifikuara për katër muajt e ardhshëm. Për plotësim të llogarisë së veçantë, pala e autorizuar (nëse është e mundur, e siguar nga pala e tretë e autorizuar) do të paraqesë të dhëna së bashku me Kërkesën për Plotësim pasi shpenzimet prej të paktën 50 % të depozitës fillestare të mund të

argumentohen. (Kërkesa për plotësim, shihni modelin në shtojcën B/aneksi 3 “kushtet plotësuese”). Shuma që duhet të plotësohet i nënshtrohet paraqitjes së një parashikimi të ri të shpenzimeve për katër muajt e ardhshëm”).

Në çdo rast, të dhënat e përdorimit të fondeve duhet të paraqiten maksimumi katër muaj pas pagesës pararendëse, pavarësisht nëse shuma e lartpërmendur minimale e shpenzimeve është plotësuar. Nëse ky afat nuk mund të respektohet, KfW do të informohet menjëherë për gjendjen aktuale (shihni pikën 8 “kushtet plotësuese”).

Në rast se shuma për të cilën janë siguruar të dhëna të përdorimit të fondeve nuk do të jetë e mjaftueshme për plotësim ose nuk kërkohet asnjë plotësim, kjo shumë do të kompensohet kundrejt shumës së depozitës fillestare.

Pala e autorizuar cakton një auditues të jashtëm për të shqyrtuar çdo vit (në përputhje me termat e referencës së KfW-së për audituesit, shtojca C) nëse fondi i disponimit është administruar siç duhet. Auditit përfundimtar do të kryhet gjashtë muaj pas disbursimit të fundit nga llogaria e veçantë. Një kopje e çdo raporti audituesi do t'i dërgohet KfW-së në kohën e duhur pas përfundimit të periudhës nën rishikim.

Në rast devijimesh midis kushteve plotësuese dhe “dispozitave të veçanta”, këto të fundit do të jenë të vlefshme.

Procedura e drejtpërdrejtë e disbursimit (fondet e mbetura të investimit)

Pala e autorizuar do t'i dërgojë KfW-së një kërkesë për tërheqje të nënshkruar rregullisht (nënshkrime të autorizuar) (shihni shtojcën E) me emrin e përfituesit dhe udhëzimet e pagesës (informacione të plota bankare).

Dokumente që mbështesin kërkesën për tërheqje, kurdoherë që është e zbatueshme:

Sipas procedurës së drejtpërdrejtë të disbursimit, pala e autorizuar duhet të përshijë dokumentet e mëposhtme në kërkesën e tërheqjes, sipas rastit:

- Kopje të faturave tregtare për mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen. Faturat duhet të përgatiten sipas specifikimeve të përcaktuara në kontratat për mallra dhe/ose shërbime.

Për më tepër, në rast se nuk kontraktohet asnjë konsulent zbatimi dhe rritja e çmimit është faturuar:

- të dhëna për bazat e rëna dakord në kontratë për llogaritjen e çmimit.

- Kopje të dëftesave të ngarkesave nëse tarifat e transportit duhet të paguhet dhe të mos përfshihen në shumën e kontratës ose nëse janë të pagueshme me koston aktuale.

- Për furnizimet nga jashtë vendit, kopje të dokumenteve të dërgesave (për shembull fletëngarkesat në bord, faturat shoqëruese të mallrave, dëftesat e dërgesave në rrugë ajrore, që përcaktojnë emrin dhe flamurin e anijes ose tipin dhe kombësinë e ndonjë mjeti tjetër transporti, llojin dhe cilësinë e mallrave të dërguara, si dhe vendin dhe datën e dërgesës.

- Sipas rastit, kopje të garancive bankare dhe certifikatave të pranimit që duhet të përgatiten në përputhje me kontratën për mallra dhe/ose shërbime dhe certifikatat mbi progresin e projektit.

- Një konfirmim për faturën nga konsulenti i kontraktuar në zbatimin e projektit, që deklaron:

- se mallrat dhe shërbimet e faturuara janë siguruar siç duhet dhe pagesa e tyre është e kërkueshme,

- se të gjitha dokumentet që duhet të paraqiten (përfshirë garancitë) janë në përputhje me kushtet kontraktuale dhe rregulloret/standardet e KfW-së,

- se të gjithë elementët e nevojshëm për zbatimin e klauzolës së rritjes së çmimit janë plotësuar dhe rritja e çmimit të faturuar është argumentuar.

Njoftime për debinë do t'i shpërndahen automatikisht përfituesve të marrëveshjes së veçantë dhe palëve të tjera të përfshira, siç i janë komunikuar KfW-së nga pala e autorizuar.

Ju lutem kontaktoni me zyrtarin e lartpërmendur të KfW-së, nëse keni pyetje rreth procedurës së disbursimit, duke cituar numrin e referencës së KfW-së.

Shtojca

- A) Modeli i një shkrese që cakton nënshkruesit e autorizuar
- B) Kushtet plotësuese të KfW-së për disbursime sipas procedurës së fondit të disponimit (duke përfshirë formularin për kërkesën për tërheqje)
- C) Termat e referencës për audituesit
- D) Formulari i tërheqjes për konsulentët në procedurën e drejtpërdrejtë të disbursimit
- E) Formulari i tërheqjes në procedurën e drejtpërdrejtë të disbursimit

## MODELI I NJË SHKRESE QË CAKTON NËNSHKRUESIT E AUTORIZUAR

Nga : \_\_\_\_\_

*Pala e përfaqësuesit të autorizuar sipas marrëveshjes së huas/financimit/projektit/ programit)*

Për: KfW Bankengruppe

Në vëmendje të: L3a4Postfach 11 11 4160046 Frankfurt am Main

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Republikën e Shqipërisë

Marrëveshja e huas dhe programit (huaja)

Marrëveshja e financimit dhe programit (kontributi financiar) e siguruar nga Bashkimi Europian

Fondi i investimit social IV

20 milionë euro – huaja

Referenca e KfW-së nr.: 2009 65 749

8,820,000 euro- kontributi financiar

Referenca e KfW-së nr.: XXXX XX XXX

I/e nderuar zotëri/zonjë,

Duke iu referuar marrëveshjes së huas/financimit/projektit/programit për projektin/programin e lartpërmendur, do dëshironim t'iu informonim se çdokush prej personave, modeli i vërtetuar i nënshkrimit të të cilit paraqitet në këtë shkresë, është i autorizuar të nënshkruajë kërkesën për tërheqje në emër të Huamarrësit/përfituesit/ agjencisë së zbatimit të programit/projektit

a) Emri:

Funksioni:

Modeli i nënshkrimit: \_\_\_\_\_

b) Emri:

Funksioni:

Modeli i nënshkrimit: \_\_\_\_\_

c) Emri:

Funksioni:

Modeli i nënshkrimit: \_\_\_\_\_

Të gjitha njoftimet e mëparshme (nëse ka) që kanë nënshkrimet e zyrtarëve të autorizuar për të nënshkruar kërkesat për tërheqje sipas kësaj/huaje/kontributi financiar, anulohen.

Me respekt,

*Firma e përfaqësuesit të autorizuar të marrëveshjes së huas/financimit/projektit/ programit datë*

**Shënim.** Në rast se çdo kërkesë duhet të nënshkruhet nga më shumë se një zyrtar, autorizimi duhet ta deklarojë këtë qartë. Nëse nënshkruesit e autorizuar janë ndarë në dy grupe dhe kërkohet nënshkrimi i përbashkët, kjo gjithashtu duhet të deklarohet qartë

Kushtet plotësuese të KfW -së  
për pagesat sipas procedurës së fondit të disponimit (kushtet plotësuese)

Kushtet e mëposhtme janë të zbatueshme për pagesat sipas procedurës së aprovuar të fondit të disponimit:

1. Pas marrëveshjes paraprake me KfW-në pala e autorizuar <sup>1)</sup> do të kujdeset për hapjen e një llogarie të veçantë (llogaria e veçantë) me një bankë të njohur (banka përgjegjëse për llogarinë) që do të mbahet në emër të saj ose në emër të një pale të tretë të autorizuar nga pala e autorizuar dhe, konkretisht, për të trajtuar:

a) shpenzimet në monedhë të huaj:

me një bankë tregtare në Gjermani ose në ndonjë vend tjetër nga i cili duhet të bëhet shumica e prokurimeve.

b) shpenzimet në monedhë vendase:

me një bankë tregtare/bankë qendrore në vendin e palës së autorizuar. Në masën që është e mundur, kjo llogari duhet të mbahet si llogari në monedhë të huaj në vendin e palës së autorizuar, me qëllim shmangien e humbjeve nga zhvlerësimi i monedhës dhe për të lejuar ritransferimin në çdo kohë; në raste të përshtatshme, shpenzimet në monedhë të huaj mund të bëhen edhe nga kjo llogari.

Llogaria e veçantë duhet të mbahet ekskluzivisht për transaksionet e pagesave sipas fondit të disponimit mbi një bazë kredie. KfW ka të drejtën të marrë informacion në çdo kohë për këtë llogari.

2. Nëse nuk bihet dakord shprehimisht ndryshe, KfW do të bëjë një depozitë fillestare me kërkesën e Palës së Autorizuar deri në një shumë që mbulon shpenzimet e planifikuara për katër muaj, në momentin që

a) është njoftuar për emrin dhe vendin e bankës përgjegjëse për llogarinë e veçantë dhe të mbajtësit të llogarisë, si dhe për numrin e llogarisë dhe alokimin (projekt/program/masë, natyra e llogarisë, për shembull llogari besimi) e Llogarisë së Veçantë; dhe ka marrë një Konfirmim të Bankës përgjegjëse për Llogarinë në formën e kërkuar nga KfW-ja (shihni Aneksin Nr. 1);

b) është paraqitur një parashikim i shpenzimeve për periudhën përkatëse

c) janë plotësuar të gjitha parakushtet e mbetura kontraktuale;

d) KfW pret gjithashtu që fondet të përdoren pa vonesë.

Nëse mbajtësi i llogarisë është palë e tretë e autorizuar

e) duhet të paraqitet edhe një deklaratë alokimi

(shihni aneksin nr.2).

Në rast se pala e autorizuar aplikon për një rritje të depozitës fillestare (parapagim), paraqitet një parashikim i përditësuar i shpenzimeve, i shoqëruar me një kërkesë për tërheqje të nënshkruar rregullisht.

3. Pagesat mund të bëhen vetëm për qëllimin e rënë dakord dhe vetëm për masat e miratuara nga KfW-ja me shkrim (për shembull, mbi bazën e kontratave të lidhura të furnizimit dhe shërbimit, grafikeve të koston dhe kohore për realizimin e punës së kontraktuar, listat e prokurimit të rëna dakord me KfW-në etj).

4. KfW do të plotësojë fondin e disponimit, me kërkesë të palës së autorizuar/palës së tretë të autorizuar, brenda shumës maksimale të rënë dakord sapo të ketë marrë brenda periudhës së rënë dakord dhe të pranuar, të dhënat e duhura dokumentuese të shpenzimeve në formë të thjeshtuar (shihni aneksin nr.3, modelin e kërkesës për plotësim) dhe me paraqitjen e një parashikimi shpenzimesh të planifikuara për katër muajt e ardhshëm që është i pranueshëm për KfW-në. Taksat dhe tarifat e tjera publike që duhet të paguhet nga Huamarrësi/përfituesi i projektit/agjencisë së zbatimit të programit, të kontributit financiar si dhe taksat e importit dhe në rastin e punës së kontraktuar, shpenzimet e përgjithshme administrative të Huamarrësit/përfituesit të projektit/agjencisë së zbatimit të programit të kontributit financiar, nuk mund të financohen.

5. Nëse nuk bihet dakord shprehimisht ndryshe, pala e autorizuar/pala e tretë e autorizuar do të mbajë të gjitha të dhënat origjinale dokumentuese të shpenzimeve që i korrespondojnë disbursimeve të bëra nëpërmjet fondit të disponimit (duke përfshirë pasqyrat e llogarive, konfirmimet bankare të kurseve

---

<sup>1)</sup> Perkufizimi:

Pala e autorizuar: Huamarrësi, përfituesi, agjencia e zbatimit të projektit

Pala e trete e autorizuar: për shembull, konsulenti

të këmbimit të aplikuara, garancitë bankare, çdo faturë tjetër bankare dhe çdo dokument tjetër që provon se mallrat dhe shërbimet janë dorëzuar dhe përmbushur siç duhet, pra, faturat tregtare, dokumentet e dërgesës, vërtetimet e pagesës dhe pranimit etj) deri të paktën pesë vjet pas përfundimit të masave të financuara dhe do të jenë të mundura në çdo kohë të inspektohen nga KfW-ja ose palët e treta të informuara nga KfW-ja (për shembull audituesit) ose do t'ia dërgojë ato, me kërkesë, KfW-së ose palëve të treta të autorizuara nga KfW-ja.

6. Pala e autorizuar/pala e tretë e autorizuar do të garantojë që pagesat fillestare të bëra të kompensohen ndaj mallrave të furnizuara/shërbimeve të dhëna dhe se do të përdoren zbritje të mundshme.

7. Çdo interes kredie do të përdoret për masat sipas pikës 3 më sipër.

8. Nëse shumat e disponueshme në fondin e disponimit nuk nevojitet e plotë, në kundërshtim me planin (pra, shpenzimet për 4 muaj), pala e autorizuar/pala e tretë e autorizuar do të shlyejë me pëlqimin e vet dhe do të informojë KfW-në për çdo fond që nuk kërkohet, nëse nuk është arritur një marrëveshje për të kundërtën.

9. Pala e autorizuar/pala e tretë e autorizuar do të garantojë që të gjitha të dhënat dokumentuese të pranuar të shpenzimeve të jenë plotësisht në dispozicion të KfW-së brenda gjashtë muajve pas përfundimit të masave/përfundimit të projektit/programit ose pas disbursimit të plotë të fondeve të synuara për fondin e disponimit.

Çdo shumë që nuk mund të provohet në nivel të mjaftueshëm që është shpenzuar për qëllimin e rënë dakord, do t'i kompensohet KfW-së menjëherë nga pala e autorizuar/pala e tretë e autorizuar.

10. KfW nuk është më e detyruar të plotësojë fondin e disponimit dhe ka të drejtë të anulojë çdo kredi që është ende në fond, nëse ka të drejtë ndaj Huamarrësit/përfituesit të huas/kontributit financiar për të pezulluar disbursimet sipas marrëveshjes së huas/financimit.

11. KfW ka të drejtë në çdo kohë

a) të zvogëlojë volumin e fondit e disponimit dhe

b) të kërkojë kompensimin e shumave që nuk janë provuar në nivel të mjaftueshëm se janë përdorur si duhet.

12. Të gjitha shlyerjet në favor të llogarisë përkatëse të marrëveshjes së huas/financimit/projektit/programit duhet të bëhen nëpërmjet Deutsche Bundesbank (MARKDEFF) për KfW, Frankfurt am Main (BIC: KFWIDEFF; BLZ 500 204 00 llogaria nr.38 000 000 00 (IBAN DE53 5002 0400 38 000 000 00), duke cituar numrin e referencës së KfW-së.

Aneksi nr.1: Modeli për "Konfirmimin e bankës përgjegjëse për llogarinë" sipas pikës 2.a.

Aneksi nr. 2:Modeli për "Deklaratën e alokimit" sipas pikës 2.e. (e zbatueshme vetëm nëse llogaria e veçantë mbahet në emër të një pale të tretë të autorizuar).

Aneksi nr. 3:Modeli për "Kërkesën për tërheqje për plotësim dhe paraqitja e të dhënave dokumentuese për përdorimin e fondeve".

ANEKSI NR 1 I "KUSHTEVE PLOTËSUESE" TË KFW-SË  
EMRI DHE ADRESA E BANKËS

Konfirmimi i bankës përgjegjëse për llogarinë

KfW Bankengruppe  
TM a  
Palmengartenstrasse 5-9  
60325 Frankfurt am Main  
Federal Republic of Germany

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Republikën e Shqipërisë  
Marrëveshja e huas dhe programit Fondi i investimit social IV  
20 milionë euro – huaja  
Referenca e KfW-së nr.: 2009 65 749  
8,820,000 euro- kontributi financiar  
Referenca e KfW-së nr.: XXXX XX XXX

(Pala e autorizuar ose pala e tretë e

Autorizuar)..... na ka kërkuar me anë të  
shkresës së datës ..... të hapë një llogari të veçantë që duhet të  
mbahet vetëm mbi bazë kredie për pagesat të cilat duhet të bëhen nga fondet e  
Bashkëpunimit Financiar Gjerman ose programe të ngjashme të KfW-së.

Rrjedhimisht, ne kemi hapur një llogari të veçantë nr. .... për pagesat nga  
huaja/kontributi financiar i mësipërm në emër të ..... të mbajtur në  
monedhën e .....(Kodi ISO).

Ne kemi marrë në konsideratë se llogaria e mësipërme do të financohet dhe plotësohet me fonde  
të posaçme nga huaja/kontributi financiar i/e mësipërm/e dhe kështu heqim dorë nga kërkitimi i të drejtës  
sonë për kompensim dhe ruajtje, si dhe nga e drejta jonë për mbajtje peng në lidhje me këto balanca për  
të cilat jemi autorizuar sipas kushteve tona të përgjithshme bankare ose për të cilat mund të jemi  
autorizuar për arsye të tjera. Ne do t'iu informojmë pa vonesë për çdo rregullim të vendosur nga palët e  
treta mbi Llogarinë e Veçantë të mësipërme.

Pala/ët/personat e autorizuar për të përdorur llogari është/janë

Ne nuk do të ndryshojmë autoritetin për të përdorur llogarinë e mësipërme, nëse dhe derisa të  
kemi marrë pëlqimin e KfW-së.

Ne autorizohemi nga Mbajtësi i Llogarisë/Pala e Autorizuar për të përdorur llogaritë, t'iu  
informojmë në çdo kohë për llogarinë dhe transaksionet e pagesës të kryera nëpërmjet llogarisë. Mbajtësi  
i Llogarisë/Pala e autorizuar për të përdorur llogarinë, na ka informuar në mënyrë të përvokueshme për  
të transferuar balancat ekzistuese mbi llogarinë e mësipërme dhe mbi çdo nënlllogari të ngjashme, në bazë  
të kërkesës suaj fillestare. Transferimi duhet të bëhet nëpërmjet Deutsche Bundesbank (MARKDEFF) për  
KfW, Frankfurt am Main (BIC: KFWIDEFF; BLZ 500 204 00 llogaria nr. 38 000 000 00 (IBAN DE53  
5002 0400 3800 0000 00), duke cituar numrin e referencës së KfW-së.

Ky konfirmim i bankës aplikohet njëllë për çdo nënlllogari.

\_\_\_\_\_

Datë

\_\_\_\_\_

Vula dhe firma ligjërishme e detyrueshme e bankës  
përgjegjëse për llogarinë

ANEKSI NR. 2 I "KUSHTEVE PLOTËSUESE" TË KFW-SË

Emri dhe adresa e palës së tretë:.....

Deklarata e caktimit të palës së tretë të autorizuar  
nëse llogaria hapet në emër të saj si llogari besimi

KfW Bankengruppe  
TM a  
Palmengartenstraße 5-9  
60325 Frankfurt am Main  
Federal Republic of Germany

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Republikën e Shqipërisë  
Marrëveshja e huas dhe programit Fondi i investimit social IV  
siguruar nga Bashkimi Europian  
Fondi i investimit social IV  
20 milionë euro – huaja  
Referenca e KfW-së nr.: 2009 65 749  
8,820,000 euro- kontributi financiar  
Referenca e KfW-së nr.: XXXX XX XXX

Masa e projektit/programit: .....

Llogaria e veçantë nr./monedha.....

Banka përgjegjëse për llogarinë:.....

Në ..... ne hapëm llogarinë nr. .... në emrin tonë me  
..... (emri i bankës përgjegjëse për llogarinë) në të cilën ju do të paraqisni  
pagesat në lidhje me zbatimin e projektit/programit ..... (përcaktimi i masës) të  
financuar nga ana juaj në përputhje me procedurën e fondit të disponimit të vendosur nga ju dhe për të  
cilën na keni njoftuar. Ne do të përdorim këto fonde vetëm për pagesa për mallrat dhe shërbimet (përveç  
shërbimeve tona të paguara) të synuara për projektin/programin e mësipërm.

Me anë të kësaj ju transferojmë secilën dhe të gjitha balancat mbi llogarinë e lartpërmendur.

Kjo deklaratë aplikohet njëllë për çdo nënllogari.

.....  
Datë

.....  
firma e mbajtësit të llogarisë/palës së autorizuar për të  
bërë Tërheqje

.....  
Konfirmimi i firmës nga banka përgjegjëse për llogarinë

Nëse llogaria mbahet me një bankë në Gjermani në emër të një shtetasi, me qëllim shmangien e  
rrezikut të zbritjes së parapaguar të taksës së prodhimit të kapitalit, është e nevojshme që mbajtësi i  
llogarisë t'i provojë bankës gjatë hapjes së llogarisë, se ajo është llogari besimi dhe se përfituesi i kësaj  
llogarie nuk ka as zyrën kryesore, as selinë në Gjermani.



ANEKSI NR. 3 I "KUSHTEVE PLOTËSUESE" TË KFW-SË

.....

Datë.....

(Emri dhe adresa e palës/palës së tretë të autorizuar për të kërkuar plotësim)

KfW Bankengruppe  
Në vëmendje të. TM a  
Palmengartenstraße 5-9  
60325 Frankfurt am Main  
Federal Republic of Germany

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Republikën e Shqipërisë  
Marrëveshja e huas dhe programit  
Fondi i investimit social IV

Emri i projektit/programit/masës: .....

Llogaria e veçantë nr./monedha.....

Banka përgjegjëse për llogarinë: .....

Kërkesa për tërheqje nr:.....

Kërkesa për plotësim dhe paraqitja e të dhënave dokumentuese për përdorimin e fondeve sipas procedurës së fondit të disponimit për periudhën e .....

I/e nderuar zotëri/zonjë,

Në pajtim me procedurën e rënë dakord të fondit të disponimit, ju bashkëlidhim të dhëna dokumentuese mbi përdorimin e fondeve në formë të thjeshtuar që vërtetojnë përdorimin e euros/ndonjë monedhe tjetër.....(kodi ISO). Këto të dhëna përbëhen nga:

1.  Deklarata e pajtueshmërisë për llogarinë/të e veçantë/a, së bashku me deklaratat bankare të llogarisë për të gjithë periudhën përkatëse, nënanksi nr.1.

2.  Pasqyra e shpenzimeve për mallrat/shërbimet e ofruara mbi bazën e marrëveshjes së veçantë, aneksi "kostoja totale dhe financimi", rënë dakord me KfW-në për çdo lloj specifik të masës, nënanksi nr 2.

Ne konfirmojmë se shpenzimet nga llogaria e veçantë dhe nënllogaritë e saj janë bërë dhe argumentuar në përputhje me dispozitat për procedurën e fondit të disponimit dhe nuk janë financuar nga burime të tjera. Të dhënat dokumentuese origjinale ruhen në zyrën tonë në ..... dhe janë të disponueshme për inspektim në çdo kohë nga ana juaj ose nga ndonjë palë e tretë e autorizuar nga KfW-ja.

Ne kërkojmë plotësimin e llogarisë së veçantë të fondit të disponimit

Nr.....të mbajtur në emër të .....

.....

me.....Bank (emri dhe vendi i bankës përgjegjëse për

llogarinë <sup>2</sup>) në shumën prej euro/monedhë tjetër .....(kodi ISO).....

.....

Nënshkrimi i palës/palës së tretë të autorizuar për të kërkuar plotësim

Nënanksi nr. 1: Deklarata e pajtueshmërisë

Nënanksi nr. 2: Pasqyra e shpenzimeve

<sup>2</sup> Për më tepër, nëse banka e pagesit nuk ndodhet në vendin e monedhës së pagesës, duhet të sigurohet emri dhe adresa e përfaqësuesit të bankës në atë vend.

Nënaneksi nr. 1 i kërkesës për tërheqje nr.....  
 KfW Ref. nr.:.....  
 Pajtueshmëria e llogarive të veçanta/ për periudhën e kontabilitetit nga..... deri më .....  
 llogaria e veçantë nr..... më .....(emri i bankës)

		Euro
<b>1.</b>	<b>Balanca e llogarisë në fillim të periudhës së kontabilitetit (sipas deklaratës së llogarisë)</b>	
<b>2.</b>	<b>Shumat e kredituara</b>	
	a) Shumat e marra nga KfW-ja	
	b) Interesi i kredisë	
	<b>Totali i kredituar</b>	
<b>3.</b>	<b>Shumat e debituar</b>	
	a) Pagesat e kryera në periudhën aktuale sipas kolonës 4 të nënaneksit 2 (pasqyra e shpenzimeve - SOE)	
	b) Tarifatat bankare	
	c) Transferrat në llogarinë e monedhës vendase (nëse është e mundur)	
	<b>Totali i debituar</b>	
<b>4.</b>	<b>Balanca e llogarisë në fund të periudhës së kontabilitetit (sipas deklaratës së llogarisë)</b>	
<b>5.</b>	<b>Shpenzimet e planifikuara për katër muajt e ardhshëm</b>	
<b>6</b>	<b>Shuma që duhet të plotësohet (5 minus 4)</b>	

Nëse është e zbatueshme, edhe për:  
 Llogarinë e veçantë lokale nr.....më .....(emri i bankës)

		Monedha lokale
<b>1.</b>	<b>Balanca e llogarisë në fillim të periudhës së kontabilitetit (sipas deklaratës së llogarisë)</b>	
<b>2.</b>	<b>Shumat e kredituara</b>	
	a) Transferimi nga llogaria nr .....(llogaria e veçantë në euro)	
	b) Interesi i kredisë	
	<b>Totali i kredituar</b>	
<b>3.</b>	<b>Shumat e debituar</b>	
	a) Pagesat e kryera në periudhën aktuale sipas kolonës 4 të nënaneksit 2 (pasqyra e shpenzimeve- SOE)	
	b) Tarifatat bankare	
	<b>Totali i debituar</b>	
<b>4.</b>	<b>Balanca e llogarisë në fund të periudhës së kontabilitetit (sipas deklaratës së llogarisë)</b>	
<b>5.</b>	<b>Shpenzimet e planifikuara për katër muajt e ardhshëm</b>	
<b>6</b>	<b>Shuma që duhet të plotësohet (5 minus 4)</b>	

Datë.....firma.....pala e autorizuar/pala e tretë e autorizuar

Nënaneksi 2 i kërkesës për tërheqje nr:.....(plotësimi) i datës.....

Pasqyra e shpenzimeve (SOE)

Referenca e KfW-së Nr: ..... .	<b>Emri i projektit/programit:</b>  ..... ....	Periudha e kontabilitetit:  Nga.....deri..... ...
--------------------------------------	---	--

Kolona 1*	2	3	4	5	6
Nr. i njëpasnjëshëm dhe përshkrim i masave specifike	Shuma e masës (siç bihet dakord)/  Monedha:	Shpenzimet në periudhën pararendëse të kontabilitetit  Monedha:	Shpenzimet në periudhën aktuale të kontabilitetit  Monedha:	Shpenzimet totale  Monedha:	Ende e padisbursuar (kolona 2 minus kolonën 5)  Monedha:
<b>TOTALI</b>					

Ne konfirmojmë se mallrat dhe shërbimet nuk janë financuar tashmë nga grantet ose huat afatgjata.

Datë.....

Datë.....

.....

Nënshkrimi i palës së autorizuar, nëse është e zbatueshme

Nënshkrimi i konsulentit

*\*Ju lutem rendisni elementet sipas atyre të treguara në aneksin e marrëveshjes së veçantë "Kostoja totale dhe financimi".*

## TERMAT E REFERENCËS: AUDITI I "FONDIT (EVE) TË DISPONIMIT"

### Objektivi

1. Objektivi i auditit të fondit (eve) të disponimit, duke përfshirë llogarinë e veçantë të hapur me ... [emri i bankës], është që të lejojë audituesin të shprehë një opinion në lidhje me raportet financiare (d.m.th. gjendja e llogarive dhe deklarata e kumuluar e përcaktuar në aneksin "Procedura e disbursimit" e marrëveshjes së veçantë) dhe pasqyrat e shpenzimeve të bazuara në kërkesat për tërheqje për fond (e) të disponimit. Këto shpenzime janë bërë sipas situatës financiare të huas/grandit të KfW-së nr. ... [referenca e KfW-së nr.] për financimin e ... [(pjesë e) emri i projektit/programit].

2. Auditimi do të kryhet çdo vit (Periudha e auditimit) dhe raporti (et) përkatës/e duhet të paraqiten jo më vonë se 6 muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar. Gjatë periudhës së auditimit disbursimet totale që arrijnë shumën prej ... janë transferuar në fondin (et) e disponimit.

### Fusha e veprimit

3. Auditimi do të kryhet në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të publikuara nga Bordi Ndërkombëtar i Auditimit dhe Standardeve të Garancisë të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve, me referencë të veçantë ndaj ISA 800 (raporti i audituesve për angazhimet e auditit të posaçëm) dhe do të përfshijë ato teste dhe kontrolle që audituesi i çmon të nevojshme, si dhe vizitat në terren, nëse çmohet e nevojshme. Audituesi duhet të ketë parasysh se për përgatitjen e një opinionit auditimi, ai duhet të kryejë një auditim përputhshmërie dhe jo një auditim normal zyrtar.

Përgatitja e raporteve financiare dhe pasqyrave të shpenzimeve për faturat e parave dhe bazën e llogaritjes së disbursimit është përgjegjësia e agjencisë së zbatimit të projektit. Informacioni financiar duhet të përgatitet në përputhje me standardet e aplikuara sipas rregullave të kontabilitetit dhe marrëveshjen kryesore të huas/financimit, duke përfshirë marrëveshjen korresponduese të veçantë.

Opinionit i audituesit, i përfshirë në raportin e opinionit të audituesit, do të deklarohet qartë nëse:

a) Pagesat nga fondi (et) e disponimit janë bërë në përputhje me marrëveshjen (t) përkatëse (të huas/financimit) dhe marrëveshjen korresponduese të veçantë. Nëse identifikohen shpenzime të papranueshme, ato duhet të shënohen veçmas.

b) Fondi (et) e disponimit duhet të mbahen në përputhje me dispozitat e marrëveshjes (së huas/financimit) dhe marrëveshjes së veçantë (duke përfshirë kushtet plotësuese të KfW-së për pagesat sipas procedurës së fondit të disponimit). Kjo përbën gjithashtu interesin e përfutur nga balancat.

c) Shpenzimet mbështeten nga të dhëna të duhura dhe të besueshme. Të gjitha dokumentet dhe të dhënat mbështetëse në lidhje me pasqyrën e shpenzimeve të paraqitura si bazë për kërkesat për tërheqje janë vënë në dispozicion.

d) Pasqyrat e audituara të shpenzimeve mund të merren si bazë për argumentimin e kërkesave të ngjashme për tërheqje. Duhet të ekzistojë një lidhje e qartë midis pasqyrave të shpenzimeve, kërkesave për tërheqje të paraqitura KfW-së dhe të dhënave të kontabilitetit.

e) Mallrat dhe shërbimet e financuara janë prokuruar në përputhje me marrëveshjen përkatëse (të huas/financimit) dhe marrëveshjen e veçantë.

f) Janë identifikuar të meta dhe dobësi specifike në sistemet dhe kontrollet e brendshme të agjencisë së zbatimit të projektit. Nëse identifikohen të meta, ato duhet të shënohen veçmas.

### Raportet

#### 4. Raporti (et) e auditit:

- a) do të lëshohen nga audituesi në gjuhën angleze;
- b) do të përfshijnë të gjitha aspektet e përcaktuara në paragrafin pararendës (fusha e veprimit);
- c) do të përmbajnë këto terma reference si pjesë përbërëse;
- d) do të sigurojnë një grafik që tregon faturat dhe disbursimet gjatë periudhës së auditimit;
- e) do të përfshijnë balancën e llogarisë (ve) të veçantë/a dhe të gjitha nënlllogaritë (nëse ka) në fillim dhe në përfundim të periudhës së auditimit;
- f) do të përfshijnë deklaratat e audituesit për të vlerësuar dhe përcaktuar nivelin e pasojave të të metave specifike, nëse ka.

5. Nëse çmohet e nevojshme, audituesi do të përgatisë edhe një "letër menaxhimi", në të cilën audituesi:

a) do të japë komente dhe vërejtje në lidhje me të dhënat e kontabilitetit, sistemet dhe kontrollet e shqyrtuara gjatë auditit (në masën që është e nevojshme për arsyetimin e raporteve financiare dhe pasqyrave të shpenzimeve);

b) do të identifikojë të metat dhe dobësitë specifike në sistemet dhe kontrollet e agjencisë së zbatimit të projektit që duhet të sillen në vëmendjen e audituesit, veçanërisht në lidhje me tërheqjen, prokurimin, ruajtjen dhe transaksionet e pagesës dhe do të bëjë rekomandime për përmirësimin e tyre;

c) do të raportojë në lidhje me masat e marra nga personeli drejtues i agjencisë së zbatimit të projektit për të bërë përmirësime mbi të metat dhe dobësitë e raportuara në të shkuarën;

d) do të sjellë në vëmendjen e agjencisë së zbatimit të projektit çdo çështje tjetër që audituesi e çmon të nevojshme.

Nga:

\_\_\_\_\_  
(Adresa e palës së autorizuar)

\_\_\_\_\_  
(datë).

KfW Bankengruppe  
TM a  
Postfach 11 11 41  
60046 Frankfurt am Main  
Federal Republic of Germany

Lënda: TM a – Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Republikën e Shqipërisë  
Marrëveshja e huas dhe programit (huaja)  
Marrëveshja e financimit dhe programit (kontributi financiar) e siguruar nga Bashkimi Europian  
Fondi i investimit social IV  
20 milionë euro – huaja  
Referenca e KfW-së nr.: 2009 65 749  
8,820,000 euro- kontributi financiar  
Referenca e KfW-së nr.: XXXX XX XXX

Kërkesa për tërheqje nr. ....

#### PROCEDURA E DREJTPËRDREJTË E DISBURSIMIT (KONSULENTI)

Në pajtim me kontratat e përcaktuara më poshtë, kopje të të cilave ju kemi dërguar, janë ofruar dhe duhet të paguhen shërbimet e mëposhtme:

Zëri Nr.*	Kontrata e konsulencës datë..... me.....	Fatura e konsulentit Nr..... datë.....	Monedha/shuma)

\* Zëri "Lista e mallrave dhe shërbimeve"

Sipas “Listës së mallrave dhe shërbimeve”, shumat e mëposhtme të pagesës së kërkueshme do të paguhën nga huaja/kontributi financiar që ne kemi kërkuar të disbursojmë si më poshtë:

Monedha/shuma .....

Përfituesi (emri dhe adresa e firmës)

.....

Llogaria nr:..... IBAN (nëse është e zbatueshme)

Emri i bankës:.....Kodi BIC: .....

.....

Banka korrespondente:\*).....Kodi BIC: .....

.....

Si provë mbështetëse është bashkëlidhur një kopje e faturës përkatëse, nëse është e mundur, së bashku me të dhëna dokumentuese të bazave të rëna dakord në kontratë për rritjen e çmimit, listën e shpenzimeve për të rimbursueshmet.

Me anë të kësaj, konfirmojmë se janë përmbushur të gjitha kushtet e disbursimit të huas të deklaruar në nenin 3 të marrëveshjes së huas.

Ne konfirmojmë se marrëveshja e lartpërmendur e huas është ende në fuqi të plotë dhe duke iu referuar marrëveshjes së huas asnjë rast dhe asnjë rast i mundshëm i mosplotësimit të detyrimeve.

Mbetemi në pritje të njoftimeve tuaja mbi debinë për disbursimet e bëra nga ana juaj.

.....

(Firma e palës së autorizuar)

\*) Për më tepër, nëse banka e paguesit nuk ndodhet në vendin e monedhës së pagesës, duhet të sigurohet emri dhe adresa e korrespondentit të bankës në atë vend. Kërkohen aplikime të veçanta për çdo monedhë të kërkuar.

ANEKSI 6

Nga:

\_\_\_\_\_  
(Adresa e palës së autorizuar)

\_\_\_\_\_  
(datë).

KfW Bankengruppe  
TM a  
Postfach 11 11 41  
60046 Frankfurt am Main  
Federal Republic of Germany

Lënda: TM a – Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Republikën e Shqipërisë  
Marrëveshja e huas dhe programit (huaja)  
Marrëveshja e financimit dhe programit (kontributi financiar) e siguruar nga Bashkimi European  
Fondi i investimit social IV  
20 milionë euro – huaja  
Referenca e KfW-së nr.: 2009 65 749  
8,820,000 euro- kontributi financiar  
Referenca e KfW-së nr.: XXXX XX XXX

Kërkesa për tërheqje nr. ....

PROCEDURA E DREJTPËRDREJTË E DISBURSIMIT

Në pajtim me kontratat/grafikët e masave të përcaktuara më poshtë, kopje të të cilave ju kemi dërguar, janë ofruar dhe duhet të paguhen mallrat/shërbimet e mëposhtme:

Zëri* nr.	Kontrata për mallrat/shërbimet e datës..... me ..... ose grafiku i masave (punimet e kontraktuara) e datës .....	Fatura nr ..... e datës ..... ose grafiku i datës .....	Shuma

\* Zëri “Lista e mallrave dhe shërbimeve”

Sipas “Listës së mallrave dhe shërbimeve”, shumat e mëposhtme të pagesës së kërkueshme do të paguhen nga huaja/kontributi financiar, që kërkojmë ta disbursoni si më poshtë:

Monedha/ shuma	Përfituesi (emri dhe adresa e kompanisë)	Numri i llogarisë/IBAN nëse është e zbatueshme	Banka / kodi BIC	Banka korrespondente <sup>3</sup> / kodi BIC

Shumat e faturave që nuk do të paguhen nga huaja/kontributi financiar na janë paguar si më poshtë:

Monedha / shuma	Përfituesi (kompania)	Data e udhëzimit për pagesë dhe banka paguese
.....	.....	.....
.....	.....	.....
.....	.....	.....

Ju bashkëlidhim si prova mbështetëse– sipas rastit: (ju lutem referojuni aneksit të procedurës së disbursimit të marrëveshjes së veçantë)

- ..... Fatura e konsulentit (sipas kushteve të pagesës së kontratës)
- ..... Faturat e furnizuesve (kopje) për çmimin bazë,  
 që përmban një konfirmim nga konsulenti
- ..... faturat e furnizuesve (kopje) për një rritje çmimi mbi bazën e një klauzole të rritjes së çmimit  
 që përmban një konfirmim nga konsulenti  
 evidenca të bazës së llogaritjes
- ..... dëftesat e ngarkesës (kopje)
- ..... dokumente dërgese (kopje)
- ..... garancitë bankare (kopje)
- ..... certifikata pranimi
- ..... certifikata për progresin e projektit

<sup>3</sup> Për më tepër, nëse banka e paguesit nuk ndodhet në vendin e monedhës së pagesës, duhet të sigurohet emri dhe adresa e korrespondentit të bankës në atë vend. Kërkojen aplikime të veçanta për çdo monedhë të kërkuar.



..... lista e shpenzimeve (punimet e kontraktuara)  
..... (.....) që përmban një konfirmim nga konsulenti (nëse është e zbatueshme)  
..... dokumente të tjera:  
.....

Me anë të kësaj konfirmojmë se të gjitha kushtet e disbursimit të huas që deklarohen në nenin 3 të marrëveshjes së huas, janë përmbushur.

Ne konfirmojmë se marrëveshja e lartpërmendur e huas është ende në fuqi të plotë dhe duke iu referuar marrëveshjes së huas asnjë rast dhe asnjë rast i mundshëm i mosplotësimit të detyrimeve.

Mbetemi në pritje të njoftimeve tuaja për debinë për disbursimet e bëra nga ana juaj.

.....  
(Firma e palës së autorizuar)

## ANEKSI 7 FONDI I INVESTIMIT SOCIAL IV

Termet e referencës për audituesit e kontributit financiar të BE-së  
Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Republikën e Shqipërisë  
Marrëveshja e huas dhe programit (huaja)  
Marrëveshja e financimit dhe programit (kontributi financiar) e siguruar nga Bashkimi European  
Fondi i investimit social IV  
20 milionë euro – huaja  
Referenca e KfW-së nr.: 2009 65 749  
8,820,000 euro- kontributi financiar  
Referenca e KfW-së nr.: XXXX XX XXX

### 1. Hyrje

Marrëveshja e kontributit e Bashkimit European (marrëveshja nr. YYYYYYY) ndërmjet Bashkimit European dhe KfW-së përcakton financimin e përbashkët të programit “Fondi i investimit social IV” dhe administrimin e kontributit të BE-së nga KfW-ja, në përputhje me procedurat e bashkëpunimit financiar gjerman (“Udhëzime për caktimin e konsulentëve në projektet e bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim” dhe “Udhëzimet për prokurimin e kontratave të punimeve dhe furnizimit sipas bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim”).

Bashkimi European jep 8,820,00 euro si grand (me përjashtim të tarifës së menaxhimit të KfW-së) për Republikën e Shqipërisë (përfituesit/Huamarrësit). KfW-ja i jep përfituesit/Huamarrësit një hua prej 20 milionë eurosh dhe i kanalizon fondet Fondit Shqiptar për Zhvillim (agjencia e zbatimit të projektit).

Sipas marrëveshjes së kontributit, grandit i BE-së dhe huaja e KfW-së do të administrohen nëpërmjet dy llogarive të ndryshme, ndërsa KfW-ja duhet të hapë një llogari të veçantë me interes për fondet e BE-së “Llogaria e veçantë shqiptare për rrugët rurale IPA 2009”. Kontributi financiar i dhënë nga Bashkimi European, si dhe interesi i fituar mbi llogarinë e veçantë do të shfrytëzohet për financimin e kontratave sipas programit që është dhënë pas ofertimit konkurrues ndërkombëtar. Pagesat sipas këtyre kontratave do të disbursohen proporcionalisht nga kontributi financiar i dhënë nga Bashkimi European dhe huaja e dhënë sipas bashkëpunimit financiar gjerman për këto kontrata.

KfW-ja disbursion huan dhe fondet e BE-së, me kërkesë të agjencisë së zbatimit të programit në përputhje me progresin e programit të financuar nëpërmjet procedurës së drejtpërdrejtë të disbursimit (për shërbimet e konsulencës), dhe procedurave të drejtpërdrejta të disbursimit (për mallrat dhe shërbimet), siç është rënë dakord në marrëveshjen e veçantë të marrëveshjes së huas dhe programit dhe marrëveshjes së financimit dhe programit ndërmjet KfW-së, përfituesit/Huamarrësit dhe agjencisë së zbatimit të programit. Për më tepër, kontratat e financuara nga huaja që nuk kalojnë shumën prej 350.000 euro disbursohen sipas procedurës së fondit të disponimit.

KfW-ja mbikëqyr përdorimin kontraktual të fondeve që ka rezervuar për mallrat dhe shërbimet specifike mbi bazën e marrëveshjes së veçantë. Lista e mallrave dhe shërbimeve, si dhe fondet korresponduese të rezervuara, formojnë kështu kuadrin brenda të cilit agjencia e zbatimit të programit mund të kërkojë disbursim nga KfW-ja pas plotësimit të të gjitha kushteve të nevojshme kontraktuale për disbursim.

## 2. Objektivi i përgjithshëm i auditit

Objektivi i përgjithshëm i auditit është që të provojë nëse fondet e BE-së sipas programit të lartpërmendur janë përdorur në përputhje me marrëveshjen e financimit dhe programit dhe marrëveshjen e veçantë ndërmjet Republikës së Shqipërisë (përfituesi), Fondit Shqiptar për Zhvillim (agjencia e zbatimit të programit) dhe KfW-së. Opinioni i audituesit, i përfshirë në raportin e opinionit të auditit, do të deklarojë qartë nëse:

1. Përdorimi i duhur i fondeve për qëllimin e përcaktuar është garantuar nga programi.

2. Nëse shpenzimet mbështeten me të dhëna dokumentuese përkatëse dhe të besueshme. Të gjitha dokumentet dhe të dhënat mbështetëse në lidhje me pasqyrat e shpenzimeve të paraqitura si bazë për kërkesat për tërheqje janë vënë në dispozicion.

3. Nëse të meta dhe dobësi specifike janë identifikuar në sistemet dhe kontrollet e brendshme të agjencisë së zbatimit të programit. Në rastin e identifikimit të të metave, ato duhet të shënohen veçmas.

## 3. Fusha e veprimit të shërbimeve

Audituesi do të shqyrtojë çdo vit derisa fondet të disbursohen plotësisht:

- arkëtimin e justifikuar me anë të dokumenteve korresponduese;

- pajtueshmërinë e procedurave të tenderimit dhe disbursimit, siç është rënë dakord në marrëveshjen e veçantë të marrëveshjes së huas dhe programit dhe marrëveshjen e financimit dhe programit;

- disbursimin e duhur sipas listës së mallrave dhe shërbimeve, siç është rënë dakord në marrëveshjen e lartpërmendur të veçantë;

- përdorimin e fondeve nëpërmjet inspektimit në vend në Shqipëri mbi një bazë gjithëpërfshirëse kampionimi.

Dokumentet e tenderit, kontratat e mallrave dhe shërbimeve, dokumentet korresponduese të dërgimit, dokumentet e ndërtimit etj., i nënshtrohen auditit të zyrës së agjencisë së zbatimit të projektit në Tiranë gjatë inspektimit në vend, me qëllim vlerësimin e përdorimit të duhur fizik të fondeve.

Auditi do të kryhet në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të publikuara nga Bordi Ndërkombëtar i Auditimit dhe Standardeve të Garancisë të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve, me referencë të veçantë ndaj ISA 800 (raporti i audituesit për angazhimet e posaçme të auditit) dhe do të përfshijë ato teste dhe kontrolle që audituesi i konsideron të nevojshme, si dhe vizita në vend nëse edhe kjo çmohet e nevojshme. Audituesi duhet të ketë parasysh se për përpilimin e opinionit të auditit, duhet të kryejë një audit përputhshmërie dhe jo një audit normal zyrtar.

## 4. Personeli

Meqë fusha e veprimit të shërbimeve është mjaft e kufizuar, një auditues do të jetë i mjaftueshëm për të kryer auditimin. Shërbimi do të realizohet nga një ekspert kontabël.

## 5. Koha e shërbimeve

Koha e nevojshme për auditim llogaritet të jetë 6 ditë në vit, duke përfshirë kohën e udhëtimit për në Shqipëri dhe raportimin. Auditimi i parë do të zhvillohet pasi të jenë disbursuar 2 milionë euro dhe më pas çdo vit.

## 6. Raportimi

Audituesi do të përgatitë një raport të shkurtër në të cilin ai përshkruan procedurat e tij të auditimit, modelet e përdorura dhe rezultatet e auditimit. Gjuha e përdorur është anglishtja. Numri i origjinaleve është 2, numri i kopjeve: 5 të printuara dhe 1 dokument elektronik (pdf i versionit të nënshkruar). Projektraporti do të dorëzohet brenda katër javësh pas auditimit dhe versioni përfundimtar 4 javë pasi të jetë komentuar nga agjencia e zbatimit të programit (Fondi Shqiptar për Zhvillim). Një version origjinal do të dorëzohet në adresën: KfW, LIIIa4, Postfach 11 11 41, 60046 Frankfurt am Main, Federal Republic of Germany.

## ANEKSI 8

### Fondi i investimit social IV Përmbajtja dhe forma e raportimit

Kërkesat e raportimit të agjencisë së zbatimit të programit gjatë programit janë si më poshtë:

- Raporte mujore nga konsulentët, duke përfshirë raportimin financiar dhe progresin e nënprojekteve.

- Çdo vit ose kurdoherë që çmohet e nevojshme, informacion mbi zhvillimet e FSHZH-së, zhvillimin e standardeve dhe politikave që cenojnë FSHZH-në, bashkëpunimin me partnerë të tjerë zhvillimi dhe zhvillime të tjera të rëndësishme nga FSHZH-ja.

- Pas përfundimit të masave duhet të bëhen vlerësime në bazë të situatës së shkuar të ndikimit socio-ekonomik, duke përfshirë treguesit e përshkruar sipas seksionit D të këtij aneksi.

- Raportet vjetore do të paraqiten në mars të çdo viti, duke përfshirë statusin aktual të treguesve të përshkruar sipas seksionit D të këtij aneksi.

Në detaje:

A) Progresi i programit

1. Statusi i përgjithshëm

Duhet të raportohet progresi i bërë në periudhën nën rishikim; çdo ndryshim në planifikim, arsyet për këtë dhe respektimi i grafikut kohor.

2. Dhënia e kontratave për shërbimet e konsulencës

Duhet të raportohet procedura e ofertimit, afatet, rezultatet dhe vlerësimi i ofertave, dhënia e kontratave (duke përfshirë datat).

3. Dhënia e kontratave për mallrat dhe shërbimet

Duhet të raportohet procedura e ofertimit, afatet, rezultatet dhe vlerësimi i ofertave, dhënia e kontratave (duke përfshirë datat).

4. Statusi i ndërtimit

Duhet të sigurohet një listë e nënprojekteve nën nënprojektet në proces dhe të përfunduara (të dorëzuara qeverisë vendore, përkatësisht Autoritetit Shqiptar të Rrugëve) në periudhën e raportimit të dalluar nga nënprojektet, si dhe vendndodhja.

5. Mirëmbajtja

Statusi i aktiviteteve të mirëmbajtjes, progresi për zbatimin e konceptit të zhvilluar të mirëmbajtjes, aktivitetet e trajnimit dhe burimi i financimit.

6. Gjendja e llogarive dhe disbursimeve

Balanca e fondit të disponimit, kërkesat për plotësim dhe transfertat e marra.

7. Respektimi i grafikut të koston dhe financimit / problemet dhe zgjidhjet

Krahasimi i synimeve me vlerat aktuale; rritja e koston, nëse ka, si dhe informacioni mbi çdo problem të lindur dhe sugjerimet për zgjidhje.

B) Kuadri institucional dhe sektorial (çdo vit)

8. Fondi Shqiptar për Zhvillim

Organizimi: zhvillimet, në veçanti performanca e departamenteve të zbatimit të programit.

9. Financimi (duke përfshirë financimin sektorial)

Buxheti vjetor, veçanërisht për ndërtimin e rrugëve rurale dhe ujësjellësin rural.

10. Përditësimi i rregullt i situatës në sektorin e rrugëve

Buxheti kombëtar për sektorin e rrugëve (ndërtimi, mirëmbajtja), numri i rrugëve të rehabilituara, projektet kryesore të rrugëve të financuara nga donatorë të tjerë etj. Informacioni mbi statusin dhe ndryshimet në rregulloret specifike sektoriale dhe legjislationin përkatës.

11. Përditësimi i rregullt i situatës në sektorin e ujit

Buxheti kombëtar për sektorin e ujit/ujësjellësit rural, numri i skemave të ujësjellësve të rehabilituar ruralë, projektet kryesore të ujësjellësve ruralë të financuar nga donatorë të tjerë etj. Informacioni mbi statusin dhe ndryshimet në rregulloret specifike sektoriale dhe legjislationin përkatës.

12. Programe të tjera (kombëtare dhe donatorë të tjerë)

Zbatuar nga FSHZH-ja: buxheti dhe rezultati i prekshëm/fizik.

C) Të tjera

13. Ngjarje të veçanta


Agjencia e zbatimit të programit do t'i raportojë menjëherë KfW-së në lidhje me ngjarje të veçanta.

D) Treguesit

<b>Treguesit</b>	<b>Njësia matëse</b>	<b>Synimi</b>	<b>Gjendja aktuale</b>
Furnizimi i vazhdueshëm (24 orë në ditë) i sigurt (standartet e OBSH-së) me ujë të pijshëm në fshatrat pjesëmarrëse në program	Standardet orë/ditë; OBSH	24	-
Mbulimi i kostove rrjedhëse, duke përfshirë mirëmbajtjen e duhur të skemave të ujësjellësve	%	Mbulohen minimalisht kostot rrjedhëse	-
Trafikueshmëria gjatë gjithë periudhës së vitit e rrugëve rurale të rehabilituara ose të rindërtuara (të matura fillimisht një vit pas përmirësimit ose rehabilitimit të seksioneve rrugore)	Po/jo	Po	-
Reduktimi mesatar i kohës së udhëtimit	%	40	-
Mirëmbajtje e shpeshtë për rrugët e financuara rajonale	E ndryshme	Mirëmbajtje rutinë e shpeshtë	-
Rritja proporcionale në volumnin e trafikut në rrugët e rehabilituara ose të rindërtuara rurale një vit pasi seksionet rrugore të jenë përmirësuar ose rehabilituar	%	10	-
Niveli i lidhjes me ujin e pijshëm të sigurt brenda zonës së furnizimit të një fshati pjesëmarrës në program	%	≥80%	-

ANEKSI 9  
FONDI I INVESTIMIT SOCIAL IV  
PROCEDURA E PËRZGJEDHJES SË SKEMAVE TË UJËSJELLËSIT RURAL

Procedura e përzgjedhjes së skemave të ujësjellësit rural



**VENDIM**  
**Nr.11, datë 12.4.2011**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Xhezair Zaganjori	anëtar	i	“	“
Petrit Plloçi	anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	anëtare	e	“	“
Sokol Sadushi	anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	anëtar	i	“	“
Admir Thanza	anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare	e	“	“
Vladimir Kristo	anëtar	i	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datë 14.12.2010 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.28/13 akti që i përket:

**KËRKUES:** Firma “Elgakoti” sh.p.k., përfaqësuar nga avokati Artan Limani dhe asistente avokate Jonida Bitraku, me autorizim.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

1. Zyra e shërbimit përbarimor Elbasan, në mungesë.
2. Drejtoria rajonale e arsimit të qarkut Elbasan, në mungesë.

**OBJEKTI:** 1. Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë nr.505, datë 10.4.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

2. Detyrimin e drejtorisë rajonale të arsimit të qarkut Elbasan për t'i shpërblyer kërkuesit dëmin pasuror e jopasuror në sasinë e vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese nëpërmjet ekspertëve.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 131/f dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo; kërkuesin, që kërkoi pranimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**  
**I**

Me vendimin nr.505, datë 10.4.2002, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur: “Detyrimin e anës së paditur drejtoria arsimore e rrethit Elbasan që t'i paguajë anës paditëse shoqëria “ Elgakoti” sh.p.k. Elbasan, detyrimin e rrjedhur nga kontrata e datës 24.1.1994 për çmimin e transportit për periudhën 1.3.1994, deri më 31.12.1994, sipas vlerave të përcaktuara në kontratë në pikën 1 të detyrimeve të përcaktuara për drejtorinë arsimore të rrethit Elbasan.”.

Në datën 27.6.2002, me vendimin nr.225, është lëshuar urdhri i ekzekutimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan për ekzekutimin e vendimit të sipërpërmendur.

Zyra përbarimore Elbasan ka proceduar me ekzekutimin e vendimit nr.505, datë 10.4.2002, duke i shlyer kërkuesit shumën prej 306.906 lekësh dhe më pas nëpërmjet vendimit me nr.495-06 të datës 28.12.2006, përbaruesi gjyqësor ka vendosur pushimin e urdhrin të ekzekutimit të sipërpërmendur.

Kërkuesi e ka kundërshtuar pushimin e urdhrin të ekzekutimit të përbaruesit gjyqësor dhe me vendimin nr.800, datë 23.4.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur:

“Anulimin e vendimit datë 28.12.2006 të Përbarimit Gjyqësor Elbasan për pushimin e urdhrin të ekzekutimit nr.225, datë 27.6.2002 të Gjykatës Elbasan, për ekzekutimin e vendimit civil nr.505 datë 10.4.2002 të Gjykatës Elbasan, pasi detyrimi nuk është përmbushur.”.

Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.10-2008-420 (487), datë 25.11.2008.

Gjykatësi i vetëm ka arsyetuar se kreditori (kërkuesi) kishte të drejtën e një shume prej 34.100 lekësh, e cila ishte derdhur nga pala debitore si tatim mbi të ardhurat pranë degës së tatimeve Elbasan.

Për sa më sipër kërkuesi i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe dëmshpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror nga debitori.

*Kërkuesi*, në mbështetje të pretendimeve të tij përpara Gjykatës Kushtetuese, parashtron në mënyrë të përmbledhur se:

- E drejta për një proces të rregullt ligjor, përfshin edhe të drejtën për të kërkuar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Organet shtetërore duhet të marrin të gjitha masat që të zbatojnë vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe jo të pengojnë në mënyrë të pajustificuar dhe të paarsyeshme realizimin e të drejtave të shtetasve që burojnë nga këto vendime gjyqësore.

- Duke qenë se në rastin konkret organi shtetëror ishte i detyruar t'i shlyente kërkuesit një sasi të hollash, detyrimi për të bërë këtë pagesë buron jo vetëm nga nenet 42,142/3 të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, por edhe nga neni 589 i Kodit të Procedurës Civile dhe nga nenet 20 dhe 21 të ligjit nr.8510, datë 15.7.1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore", si edhe nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.335, datë 2.6.1998 dhe udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.1 datë 13.6.1997.

*Drejtoria rajonale e arsimit të qarkut Elbasan* ka parashtruar me shkrim para Gjykatës Kushtetuese, se ka shlyer çdo detyrim që buron nga vendimet gjyqësore të sipërpërmendura, kundrejt kreditorit, shoqëria "Elgakoti" sh.p.k. dhe nuk ka marrë asnjë lloj ankese nga shoqëria e sipërpërmendur për shumën e derdhur për llogari të kreditorit.

## II

*Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm*

Ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm të vendimeve gjyqësore të formës së prerë është tashmë një standard i konsoliduar nga Gjykata Kushtetuese (Gjykata), si dhe nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), nëpërmjet një jurisprudence konstante.

Gjykata ka theksuar se e drejta për të kërkuar ekzekutimin brenda një afati të arsyeshëm të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të nenit 6/1 të Konventës europiane të të drejtave të njeriut (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.35, datë 27.10.2010; nr.8, datë 23.3.2010; nr.21, datë 21.7.2009; nr.9, datë 1.4.2009; nr.6 datë 31.3.2006). Nga këndvështrimi i parimeve kushtetuese, lidhur me procesin e rregullt ligjor, që burojnë nga nenet 42 dhe 142/3 të Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së, çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës dhe të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.8, datë 23.3.2010; nr.9, datë 2.4.2003; nr.11, datë 10.3.2003).

Gjykata ka pranuar se ekzekutimi i vendimit të formës së prerë konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Në raste të tilla, procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe mënyrën e kryerjes së veprimeve konkrete të organeve përgjegjëse, të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të

prekë thelbin e së drejtës (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.35, datë 27.10.2010; nr.6, datë 4.3.2010; nr.43, datë 19.12.2007*).

Gjykata, mbështetur në jurisprudencën e GJEDNJ-së, ka theksuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e saj, sjelljen e kërkesit dhe sjelljen e autoriteteve publike. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.8, datë 23.3.2010; nr.9, datë 1.4.2009*).

Në rastin konkret, periudha që duhet konsideruar për efekt të ekzekutimit të vendimit gjyqësor përbëhet nga dy faza. Faza e parë i përket vënies në ekzekutim të vendimit të formës së prerë. Fillon në datën 27.6.2002, me vendimin nr.225, me anë të të cilit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për ekzekutimin e vendimit nr.505, datë 10.4.2002 dhe mbaron në datën 25.11.2008. Pikërisht në këtë datë, nga e cila fillon dhe faza e dytë, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.10-2008-420 (487) ka lënë në fuqi vendimin nr.800, datë 23.4.2007, me anë të së cilit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur:

“Anulimin e vendimit datë 28.12.2006 të përbarimit gjyqësor Elbasan për pushimin e urdhrin të ekzekutimit nr.225, datë 27.6.2002 të Gjykatës Elbasan, për ekzekutimin e vendimit civil nr.505, datë 10.4.2002 të Gjykatës Elbasan, pasi detyrimi nuk është përmbushur.”

Duke pasur parasysh se veprimet përbarimore për ekzekutimin e vendimit kanë filluar në vitin 2002, Gjykata konstaton se afati i ekzekutimit është zgjatur në mënyrë të paarsyeshme. Pas vendimit të sipërpërmendur të Gjykatës së Apelit Durrës, i cili linte në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, që detyronte organet përbarimore të rifillonin procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm, këto të fundit duhet të viheshin menjëherë në lëvizje, duke qenë se ishin palë në proces. Për sa më sipër, vonesa që i përket gjithë fazës së dytë të periudhës së ekzekutimit të marrë në konsideratë është e pajustificueshme në kuptimin e një afati të arsyeshëm dhe të pranueshëm nga kjo Gjykatë.

Për sa i përket sjelljes së kreditorit, Gjykata vëren se ky i fundit ka përmbushur të gjitha detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ai ka shfrytëzuar të drejtën e ankimit kundër vendimit të pushimit të përbaruesit gjyqësor, në mbështetje të nenit 617 të Kodit të Procedurës Civile. Pas shfuqizimit të vendimit nga gjykata, organet përbarimore duhet të rifillonin menjëherë procedurat për ekzekutimin përfundimtar të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Mosveprimi i tyre për një periudhë gati dyvjeçare konsiderohet nga kjo Gjykatë si afat i paarsyeshëm dhe i padrejtë.

Duke qenë se objekti i kërkesëpadisë ishte shlyerja e një shume të hollash nga një organ administrativ kundrejt një personi juridik, Gjykata arrin në përfundimin se çështja nuk është aq komplekse sa që të justifikojë vonesën në ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

### III

#### *Lidhur me pretendimin për kompensimin e dëmit pasuror dhe jopasuror*

Kërkuesi ka pretenduar përpara Gjykatës edhe dëmshpërblimin financiar, të ardhur për shkak të vonesës në ekzekutimin e vendimeve.

Gjykata thekson se në sistemin tonë ligjor, kushdo që konsideron se ka pasur një shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, mund t'i drejtohet kësaj Gjykate, pasi ka shteruar të gjitha mjetet e brendshme juridike, në kuptim të nenit 131, shkronja “f” të Kushtetutës. Një kërkesë e tillë është edhe ajo që ka paraqitur kërkuesi për shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i ekzekutimit te një afati të arsyeshëm të vendimeve gjyqësore në favor të tij.

Për sa i përket kërimit për kompensimin e dëmit, si rezultat i ekzekutimit me vonesë të vendimeve gjyqësore, Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se ky është një kërkim i ri, i cili mund të paraqitet në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në bazë të dispozitave të Kodit Civil, që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit të shkaktuar, si rrjedhim i vonesës në pagimin e një shume të hollash (neni 450 i Kodit Civil). Vetëm pas shterimit të mbrojtjes juridiksionale, kërkuesi mund të vërë në lëvizje procedurat kushtetuese, në bazë të nenit 131, shkronja “f” të Kushtetutës (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.27, datë 20.6.2007 dhe nr.6 datë 6.3.2009*).



Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkesa për dëmshpërblim nuk mund të merret në shqyrtim prej saj.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe neneve 72 dhe vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës, duke konstatuar cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, nr.505, datë 10.4.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
- Rrëzimin e kërkesës për sa i përket dëmshpërblimit pasuror dhe jopasuror.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Petrit Ploçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza.

Anëtare kundër: Vitore Tusha.

#### VENDIM

**Nr.12, datë 15.4.2011**

#### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	anëtar	i	“	“
Petrit Ploçi	anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	anëtar	i	“	“
Admir Thanza	anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare	e	“	“
Vitore Tusha	anëtare	e	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datat 7.10.2010 dhe 21.10.2010 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 20/5 Akti që i përket:

**KËRKUES:** Dimitris Peitsidis, përfaqësuar nga avokati Ilir Shuraja, me prokurë

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

- Rezarta Jorgji

- zyra e përmbarimit Tiranë, në mungesë.

**OBJEKTI:** 1. Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i moszekutimit të vendimit të formës së prerë nr.120, datë 13.11.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

2. Dënimi me 100 000 (njëqind mijë) lekë gjobë të subjektit të interesuar, Rezarta Jorgji, në rast moszbatimi ose pengimi të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 6/1 i Konventës europiane për të drejtat e njeriut; nenet 510 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (i ndryshuar); nenet 27, 28, 29, 30, 31, 72, 81/4 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vitore Tusha; përfaqësuesin e kërkuarit që u shpreh për pranimin e kërkesës; subjektin e interesuar, Rezarta Jorgji, që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

### VËREN:

#### I

Me vendimin nr.9523/2008 të Gjykatës Njëanëtarëshe të Shkallës së Parë, Selanik, kërkuarit i është njohur e drejta e komunikimit me fëmijën e mitur, djalin AP, lindur më 6.10.2000. Subjekti i interesuar, RJ, së bashku me djalin është kthyer dhe jeton në Shqipëri prej datës 14.6.2008.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.120, datë 13.11.2008, ka njohur vendimin nr.9523/2008 të Gjykatës Njëanëtarëshe të Shkallës së Parë, Selanik, duke i dhënë fuqi ligjore për zbatim edhe në territorin e Republikës së Shqipërisë. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.143, datë 26.12.2008, ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për vendimin nr.120, datë 13.11.2008.

Urdhri i ekzekutimit është vënë në ekzekutim nga zyra e përbarimit Tiranë për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga vendimi i formës së prerë (titulli ekzekutiv). Përbaruesi gjyqësor ka filluar procedurat me lajmërimin e subjektit të interesuar për ekzekutimin vullnetar dhe më pas për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit të formës së prerë. Zyra e përbarimit ka vendosur, gjithashtu, gjobitjen e subjektit të interesuar në shumën 30 000 lekë (shkresa nr.3973 prot., datë 20.3.2009) dhe në shumën 50 000 lekë (shkresa nr.13252 prot., datë 13.9.2010). Gjithashtu, në referim të nenit 320 të Kodit Penal (KP), Zyra e Përbarimit, me shkresën nr.13271 prot., datë 13.9.2010, ka paraqitur kallëzim për ndjekjen penale të subjektit të interesuar për pengim të ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

*Kërkuari* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesën me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe dënimin me 100 000 (njëqind mijë) lekë gjobë të subjektit të interesuar, në rast moszbatimi ose pengimi të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar se si përbaruesi gjyqësor, i cili nuk ka ushtruar të gjitha kompetencat e parashikuara nga ligji, ashtu dhe subjekti i interesuar që ka paraqitur urdhrat e mbrojtjes, të lëshuara nga gjykata si pengesa artificiale, kanë shkaktuar mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë nr.120, datë 13.11.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë brenda afatit të arsyeshëm.

*Subjekti i interesuar, RJ*, prapësoi si vijon:

- Kërkuari nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, pasi ekzekutimi i vendimit të formës së prerë nr.120, datë 13.11.2008 i Gjykatës së Apelit Tiranë është atribut i Zyrës së Përbarimit dhe nuk përbën çështje për t'u gjykuar nga juridiksioni kushtetues.

- Pretendimi i kërkuarit për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë është i pabazuar, pasi ai është takuar rregullisht me fëmijën, në përputhje me vendimin e gjykatës, me kërkesat e zyrës së përbarimit, si edhe në prani të psikologes.

- Pretendimi i kërkuarit për vënien e gjobës është i pabazuar dhe duhet rrëzuar, pasi nuk është kompetencë e Gjykatës Kushtetuese, por e gjykatës së zakonshme.

#### II

##### *1. Në lidhje me legjitimitimin e kërkuarit*

Subjekti i interesuar ka pretenduar se kërkuari nuk legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, pasi ekzekutimi i vendimit të formës së prerë nr.120, datë 13.11.2008 i Gjykatës së Apelit Tiranë nuk përbën çështje për t'u gjykuar nga juridiksioni kushtetues, por është në kompetencë të zyrës së përbarimit Tiranë.

Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se çështja e legjitimitimit të kërkuarit lidhet drejtpërdrejt me inicimin e një procesi kushtetues. Individit, në kuptim të neneve 131, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "g" dhe pika 2 të Kushtetutës, mund të vërë në lëvizje këtë Gjykatë për çështje që lidhen















